

1 E mërkurë, 2 tetor 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit paraqitet përmes videolidhjes]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Thërrisni

6 lëndën, ju lutem.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Kjo

8 është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër

9 Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup

10 Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

12 Konstatoj që të akuzuarit marrin pjesë në seancën e sotme

13 përmes videolidhjes, u është dhënë leje për të bërë këtë gjë.

14 Sot do të fillojmë të marrim dëshminë e Dëshmitarit të

15 Prokurorisë W01163 që do të dëshmojë përmes videolidhjes.

16 Përpara kësaj, Trupi Gjykes do të japë dy urdhra gojorë.

17 Këtë gjë do ta bëjmë pa praninë e dëshmitarit, pastaj

18 kemi dhe një çështje që do ta trajtojmë në prani të

19 dëshmitarit.

20 Urdhri i parë gojor përcakton afatin kohor për

21 kundërshtimet lidhur me kronologjinë e provave të paraqitura

22 nga Mbrojtësi i Viktimave dhe kërkesat për dëmshpërblim. Trupi

23 Gjykes konstaton se gjatë seancës së djeshme mbi ecurinë e

24 çështjes, Mbrojtësi i Viktimave parashtroi se sipas tij

25 korniza ligjore e Dhomave -- siç e kupton kornizën ligjore të

1 Dhomave të Specializuara, çështjet do të paraqiten në emër të
2 viktimave pjesëmarrëse në këtë procedurë dhe do të paraqiten
3 pas mocionit të mundshëm që mund të paraqitet sipas rregullës
4 130 dhe mbi të cilën do të marrë një vendim Trupi Gjykses.

5 Po ashtu, Mbrojtësi i Viktimave parashtroi se synon të
6 paraqesë kërkesë për dëmshpërblim pas aktgjykimit të dhënë, të
7 shpallur nga Trupi Gjykses.

8 Palët urdhërohen që të parashtrojnë kundërshtimet e tyre
9 sa i përket kronologjisë siç u parashtrova nga Mbrojtësi i
10 Viktimave në afat të hënën, 2 dhjetor 2024.

11 Ky është urdhri i parë gojor.

12 Urdhri i dytë gojor ka të bëjë me rivlerësimin e pjesëshëm
13 të vendimit F0164 më 27 shtator 2024, ZPS-ja paraqiti kërkesë
14 për rivlerësim të pjesëshëm të vendimit F01664. I referohem
15 këtu parashtimit F02604 të datës 30 shtator 2024.

16 Mbrojtja paraqiti parashtimet me shkrim në F02606.
17 Mbrojtja pohon se nuk e kundërshton kërkesën e Prokurorisë për
18 rivlerësim të pjesëshëm për aq kohë sa disa redakte mbahen
19 siç janë dhe titulli, në titull dhe fjalia e parë e paragrafit
20 54 në versionin në anglisht 076841-076856 ruhet. ZPS-ja
21 konfirmoi se pajtohet me këto redakte.

22 Trupi Gjykses ndryshon vendimin F01664 në përputhje me
23 marrëveshjen e arritur mes palëve dhe urdhëron ZPS-në që të
24 parashtroj versionin e redaktuar të 076841-076854 ku
25 redaktohet titulli dhe fjalia e parë e paragrafit 54 në

1 versionin në anglisht të këtij dokumenti dhe deri në fund të
2 ditës së sotme.

3 Ky ishte urdhri i dytë.

4 Tani një çështje paraprake që do të trajtohet në prani të
5 dëshmitarit.

6 Znj. Sekretare, sillni dëshmitarin, vendosni lidhjen,
7 videolidhjen me qëllim që dëshmitari të jetë këtu dhe na
8 kaloni në seancë private për mbrojtjen e identitetit të
9 dëshmitarit.

10 [Seancë private]

11 [Seancë private teksti i fshirë]

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12 [Seancë e hapur]

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

15 Dëshmitare, shikoni dokumentin përpara jush dhe lexoni betimin

16 solemn siç kërkohet nga rregullat tona.

17 DËSHMITARJA: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] E

18 ndërgjegjshme për rëndësinë e dëshmisë sime dhe përgjegjësinë

19 time ligjore, betohem solemnisht se do të them të vërtetën,

20 gjithë të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe se nuk do të

21 fsheh asgjë për të cilën kam dijeni.

22 DËSHMITARJA: STAMENA JELIC

23 [Dëshmitarja përgjigjet përmes përkthimit]

24 [Dëshmitarja hyn në sallën e gjyqit përmes

25 videolidhjes]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
2 Znj. Dëshmitare. Mund të uleni tani.

3 Dëshmitare, sot do të fillojmë marrjen e dëshmisë suaj që
4 pritet të zgjasë një ditë, ditën e sotme. Siç e dini,
5 Prokuroria do t'ju bëjë pyetje fillimisht dhe pastaj Mbrojtësi
6 i Viktimave. Kur këta të përfundojnë, Mbrojtja ka të drejtën
7 t'ju bëjë pyetje si dhe anëtarët e Trupit Gjykses.

8 Prokuroria vlerëson se pyetjet që do t'ju bëjë juve
9 marrin një orë e gjysëm. Mbrojtësi i Viktimave ka nevojë për
10 15 minuta. Dhe Mbrojtja vlerëson se i duhen 2.5 orë për t'ju
11 bërë pyetje. Sa u përket vlerësimeve ne shpresojmë që avokatët
12 të përdorin kohën në mënyrë efektive. Siç dihet Trupi Gjykses
13 mund të bëjë pyetje, mund t'i japë mundësinë ZPS-së që të bëjë
14 pyetje së dyti, nëse kushtet për të bërë një gjë të tillë
15 plotësohen.

16 Dëshmitare, ju përpiquni t'i përgjigjeni pyetjeve në
17 mënyrë të qartë me përgjigje të shkurtra. Në qoftë se nuk e
18 kuptoni një pyetje na pyetni, na kërkoni që të përsëritet kjo
19 pyetje. Në qoftë se nuk kuptoni diçka, kërkoni që të
20 qartësohet. Gjithashtu, tregoni bazën mbi të cilën për
21 njohuritë që keni të fakteve dhe rrethanave mbi të cilat do
22 merreni në pyetje.

23 Në rast se ju bëhen pyetje nga ZPS-ja për të pohuar apo
24 ripohuar disa korrigjime që janë bërë në deklaratat e tuaja,
25 ju kujtojmë që duhet të konfirmoni në procesverbal se

1 deklarata me shkrim, si dhe versioni i korigjuar apo lista e
2 korigjimeve, është e saktë dhe pasqyron deklaratën tuaj.

3 Ju lutem flisni afër mikrofonit dhe prisni pesë sekonda
4 përpara që të përgjigjeni me qëllim që përkthyesit të kenë
5 mundësi të përkthejnë gjatë ditës së sotme apo nesër, në qoftë
6 se është e nevojshme.

7 Gjatë dhënies së dëshmisë suaj në këtë Gjykatë ju
8 kërkohet që të mos diskutoni me askënd përmbajtjen e kësaj
9 deklarate me askënd jashtë kësaj dhome gjyqi. Në qoftë se
10 dikush jashtë kësaj Gjykate ju bën pyetje lidhur me dëshminë
11 tuaj, na tregoni.

12 Në qoftë se ju kërkohet që të ndaloni, ndaloni, mos flisni
13 dhe ndërprisni fjalën tuaj në qoftë se ngre dorën. Prisni
14 udhëzimet e mia të mëtejshme.

15 Në qoftë se keni nevojë të merrni pushim, na tregoni duke
16 bërë shenjë me dorë dhe ne do të bëjmë pushim të tillë.

17 Tani do të fillojmë me pyetjet që do të parashtrojë
18 Prokuroria në emër të ZPS-së.

19 Fjalën e ka Prokuroria.

20 Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

21 Pyetje nga znj. Insinga:

22 ZNJ. INSINGA: [Përkthim]

23 PY. Mirëmëngjesi, znj. Dëshmitare.

24 PË. Mirëmëngjesi.

25 PY. Jemi takuar dhe më parë por do të prezantohem përsëri.

1 Unë jam Alexandra Insinga nga ZPS-ja. Do t'ju bëj disa pyetje
2 sot në mëngjes. Gjithashtu konstatoj, siç ju kam sqaruar dhe
3 gjatë seancës përgatitore, se në vend që t'ju bëj pyetje për
4 çdo çështje të rëndësishme apo relevante mbi të cilën keni
5 informacion, mund të jetë, është e mundur që të pranohen disa
6 nga deklaratat tuaj atë mëparshme ku gjenden këto informacione
7 dhe të pranohen në prova.

8 Për të bërë një gjë të tillë, ka disa hapa proceduralë që
9 duhet të ndiqen të cilët do t'i trajtoj pasi të marr të dhënat
10 mbi identitetin tuaj.

11 A mund të na e jepni emrin tuaj dhe mbiemrin që të
12 shënohet në procesverbal?

13 PË. Stamena Jelic.

14 PY. Datëlindja, ju lutem?

15 PË. 19 gusht 1975.

16 PY. Kombësia juaj?

17 PË. Serbe.

18 PY. Dëshmitare, në të kaluarën keni dhënë disa dëshmi
19 autoriteteve të ndryshme. Tani do t'i shfaq në ekran përpara
20 jush të gjitha këto deklaratat.

21 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares së
22 Gjykatës të shfaqë në ekran versionin serbisht dhe anglisht të
23 dokumentit ERN 030668-030669. Versioni anglisht përfundon me
24 ET I Rishikuar RED. Versioni serbisht përfundon me thjesht
25 RED2. Në qoftë se mund ët shfaqim në ekran faqen e parë të

1 secilit version.

2 PY. Dëshmitare, i shihni deklaratat përpara jush që janë në
3 ekran?

4 PË. Po.

5 PY. Kjo është një intervistë, Dëshmitare, e bërë më 3 prill
6 2002, e keni dhënë ju këtë deklaratë?

7 PË. Po.

8 PY. Faleminderit.

9 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Tani do të kërkojmë të shfaqim
10 në ekran versionin në serbisht dhe anglisht të dokumentit
11 030655 deri në 030659, faqja e parë e secilit dokument.

12 Faleminderit.

13 PY. Dëshmitare, e shikoni deklaratën që është shfaqur në
14 ekran përpara jush?

15 PË. Po, po.

16 PY. Kjo është deklaratë e datës 9 tetor 2007. E keni dhënë ju
17 këtë deklaratë?

18 PË. Shkronjat janë shumë të vogla nuk i shoh mirë.

19 PY. Mund ta zmadhojmë. Shikoni më mirë tani?

20 PË. Po.

21 PY. Në qoftë se shohim në fundin e kësaj faqes së parë, e
22 shikoni nënshkrimin aty dhe a e njihni këtë nënshkrim? Është
23 nënshkrimi juaj në fund të faqes?

24 PË. Po.

25 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Tani do kërkoja të shfaqim

1 versionin në serbisht dhe anglisht të dokumentit 009819-TR.

2 Versioni anglisht është -TR-ET Pjesa 1 RED2 dhe versioni që

3 përputhet në serbisht përkthimi, pra, është 009819-TR Pjesa 1

4 RED2.

5 PY. Dëshmitare, e shikoni dokumentin në ekran?

6 PË. Po.

7 PY. Kjo është intervistë e datës 23 janar 2014. Është kjo

8 deklaratë që e keni dhënë ju?

9 PË. Po.

10 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Dhe në fund, në qoftë se mund ta

11 shfaqim në ekran versionin në serbisht dhe anglisht të

12 dokumentit SITF00314867-00314871. Versioni në anglisht është -

13 ET RED dhe versioni serbisht përfundon thjesht me RED.

14 PY. Dëshmitare, i shikoni dokumentet në ekran?

15 PË. Po.

16 PY. Kjo është intervistë e datës 1 prill 2014. Është

17 deklaratë që e keni dhënë ju kjo që shihni?

18 PË. Po.

19 PY. Dëshmitare, në takimin përgatitor që kemi bërë në 18

20 shtator të këtij viti, a ju dha juve mundësia që të rishikoni

21 deklaratat tuaja të mëparshme?

22 PË. Po.

23 PY. A ju kujtohet që keni bërë disa sqarime dhe ndryshime në

24 këto deklaratat gjatë kësaj seance përgatitore?

25 PË. Po.

Dëshmitarja: Stamena Jelic (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Insinga

Faqe 11

1 PY. Dhe këto sqarime dhe ndryshime u pasqyruan në një shënim
2 që ju lexua juve në fund të kësaj seance përgatitore?

3 PË. Po.

4 PY. Dëshmitare, a mund të konfirmoni që përmbajtja e atij
5 shënimi që ju lexua juve pastaj pasqyron në tërësi sqarimet
6 dhe ndryshimet që ju bëtë?

7 PË. Po.

8 PY. Përveç sqarimeve dhe ndryshimeve që përmban ky shënim,
9 deklaratat tuaja a pasqyrojnë në mënyrë të saktë dëshminë tuaj
10 për atë që ju do të thonit në qoftë se do t'ju bëhen pyetje
11 përsëri për të njëjtat gjëra sot në Gjykatë?

12 PË. Po, ajo që kam thënë atëherë do ta thoja edhe tani, të
13 njëjtën gjë.

14 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, duke qenë
15 që kemi plotësuar kushtet dhe kriteret sipas rregullës 154 në
16 përputhje me vendimin F02044, ZPS-ja dorëzon deklaratat e
17 mëparshme të këtij dëshmitari në anglisht, shqip dhe serbisht,
18 përfshirë edhe provat shoqëruese, provat materiale shoqëruese
19 të identifikuara në poshtëshënimin 24 të vendimit F02044,
20 bashkë me Shënimin Përgatitor 1 të datës 18 shtator 2024, me
21 numrin ERN 122928 deri në 122935.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
23 kundërshtim?

24 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] S'ka kundërshtim.

25 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

Dëshmitarja: Stamena Jelic (Seancë e hapur)
Pyetje nga znj. Insinga

Faqe 12

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka
2 kundërshtime. Atëherë dokumenti ERN 030668 deri në 030669 në
3 anglisht, serbisht dhe në shqip pranohet.

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo do të marrë numrin
5 e provës materiale P01699.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
7 030655 deri në 030659 në anglisht, serbisht dhe shqip
8 pranohet.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo do të marrë numrin
10 e provës materiale P01700. Dhe në qoftë se mund të konfirmoni
11 ju lutem klasifikimin e dokumentit.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është publik
13 apo konfidencial?

14 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Për momentin konfidencial.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë për
16 momentin do të mbetet konfidencial.

17 Dokumenti i radhës 009819-TR-ET në serbisht, shqip dhe
18 anglisht. Është vetëm një pjesë apo sa pjesë janë këto?

19 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Janë katër pjesë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Katër pjesë.
21 Të katërt pjesët pranohen.

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Pjesa 1 do të marrë
23 numrin -- Pjesa 2 do të marrë numrin P01701.3. Dhe Pjesa 4 do
24 të marrë numrin P01704.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

1 SITF00314867 deri në 00314871 anglisht, serbisht dhe
2 shqip pranohen.

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo do të marrë numrin
4 e provës materiale P01702.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe Shënimi
6 Përgatitor, që mban numrin ERN 122928 deri në 122935 pranohet.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ky do të marrë numrin e
8 provës materiale P01703. Dhe në qoftë se mund të konfirmojmë
9 që janë të gjitha konfidenciale?

10 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Të gjitha konfidenciale.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A keni
12 dorëzuar si provë provën materiale shoqëruese?

13 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Po.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
15 Pranohen edhe këto.

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Besoj që prova
17 shoqëruese është ajo që tani e kemi dhënë numrin P01702.

18 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Prova shoqëruese ERN është
19 009812 deri në 009818, por vetëm faqja e fundit e këtij
20 dokumenti që është faqja 009818. Dhe është i njëjti dokument
21 në tre përkthimet, vetëm një prej tyre ka nevojë që të
22 pranohet.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo do të marrë numrin
25 P01704.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

2 Tavakoli, kërkoni fjalën?

3 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Thjesht po pyes nëse kërkesa e
4 kolegut tim për këto dokumente, deklarata sipas rregullës 154
5 janë konfidenciale sepse dëshmia e këtij dëshmitari do të jetë
6 në seancë të hapur dhe e bën pak të ndërlikuar në qoftë se
7 duhet, nëse ne kemi nevojë t'ju referohemi deklaratave,
8 ndërkohë që ajo po jep dëshmi publikisht. Pra, do të kërkoja
9 që këto klasifikohen si publike.

10 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Në këtë kohë që po flasim do të
11 kërkoja që të mbeten konfidenciale në mënyrë që të sigurojmë
12 që të mos përmenden të afërmit e saj apo njerëz që nuk janë
13 pjesë e këtij procesi gjyqësor, nuk marrin pjesë në këtë, dhe
14 do të kërkojmë që këta persona të mbeten të mbrojtur.

15 Besoj që mund të ketë, se ka vende ku përmenden anëtarë
16 të familjes apo fëmijë që nuk janë pjesë e pjesëmarrës në këtë
17 procedurë dhe do të kërkoni, pra, mundësinë që të rishikonim
18 pra këtë pikë dhe këtë çështje me qëllim që të bëjmë një
19 parashtrim para Gjykatës sot.

20 [Anëtarët e Trupit Gjyqësor këshillohen]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Këto të
22 gjitha dokumentet do të riklasifikohen si publike. Prokuroria
23 ka patur mundësinë që të merret me masat mbrojtëse dhe nuk e
24 ka kërkuar një gjë të tillë, prandaj do të heqim masën, do të
25 heqim konfidencialitetin. Kjo nuk do të thotë që do të jenë,

1 do të shfaqen për publikun. Thjesht do t'i heqim për nevoja të
2 kundërmarrjes në pyetje.

3 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Kuptoj, të nderuar Gjykatës. Dhe
4 në qoftë se ne përcaktojmë se ka diçka që është në përputhje
5 me vendimin tuaj që mund të kërkoj që të kalojmë në seancë
6 private për nevoja të caktuara, ne do të bëjmë një kërkesë të
7 tillë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptoj. Kjo
9 është e njëjta gjë për të gjithë dëshmitarët.

10 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të
11 propozoja të lexoja tani një përmbledhje të shkurtër të
12 deklaratës së dëshmitares sipas rregullës 154. Kjo përmbledhje
13 është dërguar palëve më 23 shtator 2024 në orën 18.47.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

15 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Në verën e vitit 1999,
16 Dëshmitari W01163, serbe, jetonte në Rahovec, bashkë me burrin
17 e saj Marko Jelic dhe pjesëtarë të tjerë të familjes. Me ose
18 rreth datës 16 qershor 1999, W01163 ka qenë dëshmitare e
19 rrëmbimit dhe keqtrajtimit të fqinjit të saj, Panta Grkovic,
20 nga ushtarë të UÇK-së. Më vonë atë ditë, Dëshmitarit W01163,
21 ju tha nga persona të tjerë, se tre serbë të tjerë që jetonin
22 në afërsi ishin marrë nga një automjet, në makinë nga
23 pjesëtarë të UÇK-së.

24 Më 9 gusht 1999, burri i W01163 u mor nga shtëpia e tij
25 nga tre anëtarë të UÇK-së në prani të W01163. Ai nuk u kthye

1 kurrë në shtëpi dhe është i zhdukur që nga ajo kohë.

2 Nëna e Marko Jelic ka kontaktuar komandantin e UÇK-së në
3 atë zonë për të marrë informacion lidhur me djalin e saj, por
4 pa sukses.

5 Nga të gjithë serbët e rrëmbyer vetëm trupi, kufoma e
6 Panta Grkovic është gjetur.

7 Me këtë përfundon përmbledhja e dëshmisë së dëshmitarit.

8 Tani, të nderuar Gjykatës, kam disa pyetje shtesë
9 qartësuese që do t'ia bëj dëshmitarit.

10 PY. Dëshmitare, në deklaratat tuaja të mëparshme keni
11 diskutuar rrëmbimin e disa serbëve të tjerë që kanë jetuar
12 afër jush apo ishin fqinjë tuaj. A jeni në gjendje të kujtoni
13 emrat e këtyre individëve sot gjatë dëshmisë suaj?

14 PË. Sveta Grkovic. Marko, nuk më kujtohet mbiemri i tij.
15 Negovan Nedic -- Dedic. Pastaj një që quhet Miljkovic dhe nuk
16 më kujtohet emri i tij.

17 PY. Faleminderit, Dëshmitare. Po Tihomir Miljkovic, a ju
18 duket një emër që e keni dëgjuar?

19 PË. Po. Po, ka qenë fqinji ynë.

20 PY. Po Marko, mbiemrin mund ta ketë pasur Vitosevic, a ju
21 duket që mund të ketë qenë ky mbiemri?

22 PË. Po.

23 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Ju kërkohet ndjesë që ju ndërpres,
24 të nderuar Gjykatës, po në qoftë se kolegja ime dëshiron që
25 t'i rifreskojë memorien dëshmitares duhet që të ndjekë

1 procedurën e duhur.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
3 kundërshtimi.

4 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Në rregull. Ju falënderoj, i
5 nderuar Gjykatës. Vazhdojmë më tej.

6 PY. Ju thatë që Tihomir ka qenë një fqinj i juaji. Po Marko
7 ka qenë po ashtu fqinj i juaji, Dëshmitar?

8 PË. Po.

9 PY. Dëshmitar, a ju kujtohet se çfarë moshe kanë pasur këta
10 dy persona që po diskutojmë, çfarë moshe kanë pasur në vitin
11 1999, nëse e dini?

12 PË. Kanë qenë persona në moshë. Nuk kanë qenë të rinj.

13 PY. A mund të na shpjegoni ju lutem, Dëshmitar, se çfarë ju
14 kujtohet që keni mësuar lidhur me këta dy persona dhe zhdukjen
15 e tyre?

16 PË. Zveto Grkovic, bashkëshortja e tij, Auntie Jela, ajo
17 erdhi në shtëpinë e një fqinji për të pyetur lidhur me burrin
18 e saj se ku ndodhej ai.

19 PY. Dëshmitar, a mund të na thoni se çfarë ju kujtohet që
20 keni mësuar lidhur me Thomir dhe Marko, këta dy personat që ju
21 thatë që kishin një farë moshe, që ishin të moshuar që nuk
22 ishin kaq shumë të rinj, a mund të na thoni?

23 PË. Tihomir e kishin rrahur dhe më pas atë e morën me një
24 veturë të një lloji të caktuar, me një si fugon. Duart i
25 kishte të lidhura. Dhe dëgjova që arriti që të ikte nga

1 fugoni.

2 PY. A ju kujtohet se si e keni mësuar këtë informacion lidhur
3 me të?

4 PË. E kam dëgjuar përmes fqinjit tim.

5 PY. Po sot që po jepni dëshmi, a jeni në gjendje të kujtoni
6 sesi e ka pasur emrin fqinji juaj?

7 PË. E kishte emrin Jela.

8 PY. Dëshmitar, a keni dëgjuar ndonjëherë ndonjë gjë -- ju
9 kërkoj ndjesë, e tërheq pyetjen.

10 Dëshmitar, a ju kujtohet sesi e ka pasur mbiemrin kjo
11 Jela që ka qenë fqinja juaj?

12 PË. Grkovic.

13 PY. Po burri i saj si e ka pasur emrin, në qoftë se ju
14 kujtohet?

15 PË. Sveta.

16 PY. Dëshmitar, a ju kujtohet të keni mësuar se ku janë
17 mbajtur të ndaluar këta persona?

18 PË. Në Rahovec, ku më përpara kanë qëndruar policia. Dhe kur
19 policia është larguar, ata janë mbajtur të ndaluar atje në
20 stacionin e policisë.

21 PY. Për të qenë e qartë për procesverbal, a mund të na thoni
22 se kush i ka ndaluar ata?

23 PË. UÇK-ja.

24 PY. Dëshmitar, a keni dëgjuar ndonjëherë ndonjë gjë se kush
25 ka qenë përgjegjës për këto zhdukje ose për këto rrëmbime?

- 1 PË. Personi përgjegjës për Rahovecin ka qenë Ismet Tara.
- 2 PY. Çfarë keni dëgjuar sa i takon përfshirjes së tij në këto
3 zhdukje ose në këto rrëmbime, nëse keni dëgjuar gjë?
- 4 PË. Kam dëgjuar nga personat në Rahovec që ai ka qenë
5 përgjegjës për zhdukjen e personave në fjalë.
- 6 PY. Po sot që po jepni dëshmi, a jeni në gjendje që t'ju
7 kujtohet se nga kush e keni dëgjuar këtë?
- 8 PË. Vjehrra ime, kur ka shkuar për të raportuar zhdukjen e
9 djalit të saj, ajo ka shkuar për t'u takuar personalisht me
10 Ismet Tarën. Këtë ma ka thënë ajo personalisht.
- 11 PY. Dëshmitar, a jeni takuar ju vetë ndonjëherë apo keni
12 folur ndonjëherë ju vetë me Ismet Tarën?
- 13 PË. Jo.
- 14 PY. Dëshmitar, personi tjetër që përmendët që ka qenë komshiu
15 juaj, Marko Vitosevic, çfarë keni mësuar lidhur me rrëmbimin e
16 tij ose me zhdukjen e tij, çfarë dini lidhur me këtë?
- 17 PË. Kam dëgjuar nga Auntie Jela që, atë ditë, këta tre
18 persona Marko Vitosevic dhe dy personat e tjerë janë rrëmbyer.
- 19 PY. A keni mësuar ju ndonjë gjë pas rrëmbimit të tyre ose a
20 keni dëgjuar ndonjë gjë pasi ata janë rrëmbyer?
- 21 PË. Jela tha që ata janë ndaluar tek zjarrfikësja.
- 22 PY. A keni dijeni në qoftë se ndonjëherë prej këtyre
23 personave është parë më pas këtij rasti, a keni dëgjuar ndonjë
24 gjë sa i takon atyre?
- 25 PË. Jo.

1 PY. Për të qenë të qartë për procesverbal, kur thoni që ajo
2 ka dëgjuar që ata janë mbajtur të ndaluar te zjarrfikësja, a
3 mund të na thoni se ku gjendej zjarrfikësja?

4 PË. Gjendej afër stacionit të policisë.

5 PY. Në Rahovec ishte?

6 PË. Po, në Rahovec.

7 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk kam
8 pyetje të tjera për dëshmitarin.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
10 Znj. Tavakoli, fjala për ju.

11 Z. LAWS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, e kam unë fjalën.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

13 Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave:

14 Z. LAWS: [Përkthim]

15 PY. Znj. Jelic, mirëmengjes. A më shihni dhe a më dëgjoni
16 mirë?

17 PË. Mirëmengjes. Po, ju shoh dhe ju dëgjoj mirë.

18 PY. Faleminderit. Ne jemi takuar dhe më herët bashkë.

19 Megjithatë dua të prezantohem për procesverbal. Unë quhem
20 Simon Laws dhe jam Mbrojtësi i Viktimave në këtë lëndë
21 gjyqësore. A e kuptoni këtë, Dëshmitar?

22 PË. Po, e di.

23 PY. Faleminderit. Sikurse e dini unë do t'ju bëj disa pyetje
24 sot lidhur me ndikimin që ka pasur ajo çfarë ju ka ndodhur ju
25 si familje, çfarë i ka ndodhur bashkëshortit tuaj, Marko dhe

1 çfarë ndikimi ka pasur ajo mbi ju dhe mbi fëmijët tuaj. Do
2 fillojmë me disa pyetje historike.

3 A është e saktë që Marko është lindur në vitin 1968?

4 PË. Jo. Po, është e saktë.

5 PY. Ju jeni martuar me të në vitin 1995, apo jo?

6 PË. Po.

7 PY. Në atë kohë keni qenë 20 vjeçe dhe Marko ka qenë 26, në
8 mos gabohem, kështu?

9 PË. Po.

10 PY. A mund t'ju thoni anëtarëve të Trupit Gjykues se çfarë
11 lloj personi ishte Marko dhe çfarë karakteri kishte ai si
12 person, si individ?

13 PË. Ai ishte njeri i mirë. Ishte njeri i zakonshëm.

14 PY. Përpara 1998, çfarë bënte ai, çfarë profesioni kishte?

15 PË. Marko ka punuar si kontabilist në Termovent.

16 PY. Dhe pastaj më vonë në vitin 1999, ai ka bërë ca punë si
17 përkthyes, si interpret për OSBE-në sepse fliste shqip,
18 anglisht dhe serbisht, apo jo?

19 PË. Po.

20 PY. A është e saktë që ju bashkë keni pasur dy fëmijë?

21 PË. Po.

22 PY. Vajza juaj a ka lindur në 1996 dhe pastaj djali në vitin
23 1997?

24 PË. Po.

25 PY. Në gusht të 1999 vajza juaj ishte tre vjeç, ndërsa djali

1 jua j ishte 2 vjeç, besoj se kështu ka qenë, apo jo?

2 PË. Po, e saktë.

3 PY. Nuk më duhet fare t'ju bëj pyetje lidhur me atë çfarë i
4 ka ndodhur Markos ditën që e kanë marrë atë, megjithatë dua
5 t'ju bëj disa pyetje lidhur me mënyrën se si humbja e tij ka
6 pasur ndikim mbi jetën tuaj, mbi jetën tënde personale po edhe
7 mbi jetën e fëmijëve tuaj. A mund t'i bëj këto pyetje?

8 PË. Duhet të më besoni që ka pasur shumë ndikim mbi ne. Vajza
9 ime ishte shumë e lidhur me të atin. Dhe kur u larguam nga
10 Rahoveci për të shkuar në Mal të Zi, në Berane në Mal të Zi,
11 vajza nuk ka folur për një muaj, megjithëse ajo kishte filluar
12 që të fliste. Ajo ulej në të njëjtën vend gjithmonë dhe e
13 kishte të fiksuar shikimin në një vend gjatë gjithë kohës,
14 ndërkohë që nuk nxirrte asnjë fjalë të vetme. Nuk fliste fare.

15 PY. Gjatë vitit të parë kur keni qenë në Mal të Zi me
16 fëmijët, a mund të na përshkruani sesi ka qenë jeta për ju?

17 PË. Singërisht, unë nuk isha fare funksionale as fizikisht
18 dhe as mendërisht. Dhe më pas kërkova ndihmë. Shkova u
19 vizitova tek një mjek. Dhe kur ai më tha disa gjëra të
20 caktuara si, për shembull, që fëmijët e mi do përfundonin në
21 një qendër për fëmijët e braktisur dhe se ata nuk do dinin që
22 ishin motër e vëllamë njeri-tjetrit, atëherë unë u mundova që
23 të mblidhja veten.

24 Dhe për një vit të plotë, në fakt, nuk isha mirë as
25 fizikisht dhe as mendërisht. Megjithatë pas një viti,

1 fatmirësisht, falë mjekëve, isha më mirë.

2 PY. Pasi kaluat ca kohë në Mal të Zi, është e saktë që juve u
3 vendosët në Serbi? Nuk është e nevojshme për neve për të
4 mësuar emrin e qytetit ku jeni vendosur, por thjesht na thoni
5 nëse është e saktë që nga Mali i Zi shkuat në Serbi?

6 PË. Po.

7 PY. Si i keni mbajtur fëmijët, financiarisht e kam fjalën?

8 PË. Kur mbërritëm në Serbi, unë kam punuar në një *fast-food*.

9 PY. Po sot, a punoni përsëri me kohë të plotë në sferën e
10 restoranteve?

11 PË. Po.

12 PY. E dimë që në vitin 2014 ka pasur një proces gjyqësor në
13 Gjykatën e Lartë në Beograd. A ka përfunduar ndonjë person në
14 gjykim, a ka pasur ndonjë gjykim për ndonjë person sa i takon
15 rrëmbimit apo vrasjes së bashkëshortit tuaj?

16 PË. Jo.

17 PY. Ne e dimë, sepse i thatë Prokurorisë në fakt, që trupi i
18 tij nuk është gjetur asnjëherë. Edhe sot ky është qëndrimi
19 juaj, pra, kjo është e vërtetë që trupi i tij nuk është gjetur
20 asnjëherë?

21 PË. Po, e vërtetë është. Trupi i tij nuk është gjetur kurrë.

22 PY. A mund t'i thoni Gjykatësve se çfarë domethënie, çfarë
23 ndikimi ka pasur kjo mbi ty?

24 PË. Ajo çfarë dua unë të di është që çfarë i ka ndodhur
25 bashkëshortit tim. Dhe do ishte mirë që të paktën të gjenim

1 qoftë edhe një kockë të vetme në mënyrë të tillë që të mund
2 t'i bënim një varr dhe të kisha një vend ku më fund mund ta
3 qaja atë.

4 PY. Para pak çastesh na treguat për ndikimin e asaj që
5 zhdukja e bashkëshortit ka pasur mbi vajzën tuaj. A mund të na
6 thoni më në përgjithësi, në retrospektivë kur e hidhni
7 vështrimin pas në kohë, a mund të na thoni se çfarë ndikimi ka
8 pasur që të rrisësh fëmijët e tu pa baba?

9 PË. Ka pasur një ndikim të jashtëzakonshëm. Edhe sot e kësaj
10 dite mungesa e babait ka ndikim mbi ta edhe pse ata tani janë
11 të rritur.

12 PY. Znj. Jelic, a dëshironi t'i thoni Gjykatësve me fjalët
13 tuaja se si ajo çfarë i ka ndodhur Markos ka pasur ndikim mbi
14 jetën tënde?

15 PË. Ka pasur shumë ndikim mbi jetën time. Është shumë e
16 vështirë të jetosh diku dhe të rrisësh dy fëmijë dhe pa asnjë
17 lloj ndihme. Është shumë e vështirë kjo gjë dhe nuk do ia
18 uroja askujt një fat të tillë. Edhe pse kjo ka ndodhur në të
19 shkuarën edhe sot e kësaj dite jeta nuk është fare e lehtë.

20 PY. Faleminderit.

21 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk kam pyetje tjera, të nderuar
22 Gjykatës.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
24 z. Laws.

25 Znj. Tavakoli. Që ta dini do bëjmë pushim në orën 10.00.

1 Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli:

2 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

3 PY. Mirëmëngjes. Unë quhem Nina Tavakoli, jam avokate e
4 Hashim Thaçit në këtë gjyq.

5 PË. Mirëmëngjes.

6 PY. A kam të drejtë kur them që ju përfunduat duke thënë që
7 përgjegjëse për rrëmbimin e bashkëshortit tuaj ishte UÇK-ja,
8 sepse kur burrat erdhën në shtëpinë tuaj njëri prej tyre tha
9 që janë nga UÇK-ja dhe se ata kishin veshur uniforma të UÇK-
10 së, a është e saktë kjo?

11 PË. Po.

12 PY. Mendoj se ju thatë që ishin fëmijë 19, 20-vjeçarë në mos
13 gabohem, kështu?

14 PË. Po.

15 PY. Dëshiroj që të na sqaroni sesa prej këtyre burrave kishin
16 uniforma të UÇK-së. Në deklaratën që i keni dhënë SITF-së keni
17 thënë që të gjithë ishin të veshur me uniformë. Ndërkohë që në
18 deklaratën që i keni dhënë MUP-it serb keni thënë që dy prej
19 tyre kanë pasur tesha civile dhe njëri ka pasur uniformë. Po
20 sot a ju kujtohet në qoftë se të gjithë kishin veshur uniforma
21 apo njëri kishte veshur uniformë?

22 PË. Unë thashë që dy prej tyre ishin me uniformë dhe njëri
23 ishte me rroba civile. Asnjëherë nuk kam thënë që të gjithë
24 kanë pas veshur uniformë.

25 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Për procesverbal referenca

1 është prova P01701 Pjesa 4, atëherë Pjesa 4, faqja 5. Do
2 kërkoja që këtë faqe të mund ta paraqisni në ekran.
3 PY. Kjo është deklarata që keni dhënë ju për SITF-në. Ju
4 thoni, të paktën sipas rreshtit të parë, që kanë qenë tre të
5 veshur me uniformë, megjithatë, a po thoni që nuk kanë qenë të
6 gjithë të veshur me uniformë? Dhe ju vazhdoni më tej dhe thoni
7 "Jo, vetëm dy ishin të veshur me uniformë". Dua që të jemi e
8 qartë.

9 Atëherë a mund të na e shpjegoni dhe një herë, mund të na
10 e sqaroni kanë qenë dy veta të veshur me uniformë, apo jo?
11 A më dëgjoni, Dëshmitar?

12 PË. Po, po. Të dëgjoj. Dy kanë qenë me uniformë dhe njëri ka
13 qenë me tesha civile.

14 PY. Faleminderit. I keni thënë gjithashtu SITF-së që, pak a
15 shumë rreth asaj kohe, familja juaj nuk largohet nga shtëpia.
16 Nuk është se shkonit në treg apo në shitore dhe që bukën dhe
17 qumështin jua sillnin fqinjët tuaj. A ju kujtohet që e keni
18 thënë këtë?

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ishte mirë
20 që të bëni pyetje, ta bëni në trajtë pyetjeje.

21 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Në rregull.

22 PY. Gjatë kësaj periudhe kohe ju nuk jeni larguar nga
23 shtëpia, apo jo? Keni qëndruar në shtëpi brenda, a është e
24 saktë kjo?

25 PË. Po.

1 PY. Vajza besoj se i ka thënë zyrës së Prokurorisë - dhe
2 referenca për këtë është ERN 122926, paragrafi 4 - që ju gjatë
3 kësaj periudhe kohe fshiheshit, realisht ju qëndronit brenda
4 për t'u fshehur.

5 PË. Nuk kemi guxuar që të dalim nga shtëpia, që të dalim në
6 rrugë.

7 PY. Kemi dëgjuar dëshmi në këtë gjykim që uniformat e UÇK-së
8 mund të bliheshin dhe në treg në verën e 1999 dhe njerëzit i
9 blinin dhe i vishnin këto uniformë dhe jo domosdoshmërisht ata
10 që i vishnin uniformat ishin me UÇK-në. Ju nuk do keni pas
11 dijeni lidhur me këtë sepse ju nuk keni dalë fare nga shtëpia
12 gjatë asaj periudhe, kështu?

13 PË. Zonjë, burri që mori bashkëshortin tim -- ata persona që
14 erdhën për ta marrë bashkëshortin tim ishin fqinjët tanë,
15 ishin të UÇK-së.

16 PY. Faleminderit. E di çfarë dini juve dhe e kuptoj atë çfarë
17 po thoni, po gjithsesi dua që ta shtjellojë më tepër këtë
18 temë.

19 Ne kemi dëgjuar gjithashtu dëshmi në këtë gjykim që
20 kufiri me Shqipërinë ka qenë i hapur gjatë kësaj periudhe dhe
21 se kishte banda kriminale të cilët kalonin kufirin.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Znj. Tavakoli, a mund të na
23 jepni referencën për këtë?

24 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Po. Është 1D00085.

25 PY. Pra, në këtë kohë kemi dëgjuar që ka pasur banda

1 kriminale të mëdha që vinin nga Shqipëria dhe që kryenin
2 krime, ndërkohë që ishin të veshur me uniforma të UÇK-së. A
3 keni dëgjuar lidhur me këtë gjë apo keni qenë shumë të izoluar
4 për të dëgjuar diçka të tillë?

5 PË. Jo, nuk kam dëgjuar asgjë lidhur me këtë.

6 PY. I keni thënë Zyrës së Prokurorisë përpara një jave gjatë
7 seancës përgatitore që njeri prej burrave kishte një kartë
8 identiteti, një distinktiv blu - dhe në shënimin përgatitor,
9 në paragrafin 15 - keni thënë që nuk e njihnit se kush ishte
10 ky person. A ju kujtohet ta keni thënë këtë?

11 PË. Po, më kujtohet

12 PY. Po keni thënë gjithashtu që ai ishte nga aty nga zona
13 lokale -- nuk ishte nga zona lokale, apo jo?

14 PË. Po.

15 PY. Në deklaratën për Prokurorinë - dhe këtu referenca është
16 P01701.2 - që ai është vetëprezantuar që ishte nga Shqipëria.
17 A ju kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

18 PË. Po, ai ka thënë që ishte nga Shqipëria. Më kujtohet kjo.

19 PY. ID-ja, karta e identitetit që ju ka treguar ishte blu,
20 apo jo?

21 PË. Po. Tha gjithashtu që atë e kishte marrë nga KFOR-i.

22 PY. Faleminderit.

23 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Do bëjmë pushim tani.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se
25 është momenti i përshtatshëm për juve, mund të bëjmë pushim.

1 Dëshmitar, do bëjmë pushim për dhjetë minuta, mund të
2 ktheheni aty ku jeni për dhjetë minuta. Mund të largoheni nga
3 ambienti ku jeni nën shoqërinë e Asistentes.

4 [Dëshmitarja përfundon dëshminë përmes
5 videolidhjes]

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
7 pushim për dhjetë minuta.

8 --- Seanca ndërpritet në orën 10.05

9 --- Seanca rifillon në orën 10.15

10 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Gjysmë orë besoj.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për qëllime
12 planifikimi.

13 [Dëshmitarja vijon dëshminë përmes
14 videolidhjes]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

16 Znj. Dëshmitare, do të vazhdojmë me pyetjet nga Mbrojtja
17 e Thaçit. Ju lutem, dëgjojeni me vëmendje.

18 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Znj. Dëshmitare, kur i thatë
19 ju Prokurorisë se pasi këta burra të morën bashkëshortin, ata
20 u kthyen mbas disa ditësh dhe ju kërkuan para në shkëmbim të
21 kthimit të tij. Të kujtohet që e ke thënë këtë?

22 PË. Po. Këtë më tha.

23 PY. Atëherë unë do t'ju them se këta burrat që të kanë marrë
24 bashkëshortin mund të kenë qenë thjesht kriminelë nga
25 Shqipëria që mund ta kenë marrë bashkëshortin tuaj për haraç

1 edhe të kenë pretenduar sikur janë të UÇK-së. Çfarë do thoshit
2 ju nëse unë do jua thoja këtë si parashtrim, si propozim?

3 PË. Atë që kërkuan paratë dhe që morën bashkëshortin tim nuk
4 ishin nga Shqipëria por ishin nga Rahoveci. Të njëjtën persona
5 që e morën ishin ata që erdhën edhe kërkuan para.

6 PY. Unë po ju them, pra, dhe -- unë po ju them që nuk ishin
7 nga UÇK-ja, por që ishin nga Shqipëria.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni
9 sepse u përgjigj.

10 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

11 PY. Gjatë kohës së periudhës së MVK-së bashkëshorti juaj ka
12 punuar për OSBE-në, apo jo?

13 PË. Po.

14 PY. Ka qenë përkthyes për Frank Ledwidge; kështu?

15 PË. Po.

16 PY. A e dini ju që Frank Ledwidge dhe OSBE-ja kryen hetime
17 për të zbuluar se çfarë i kishte ndodhur bashkëshortit tuaj?

18 PË. Jo.

19 PY. Po, ata bënë intervista në terren.

20 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Mund t'ju jap edhe referencën
21 për Trupin Gjykses, është prova që ka tashmë numrin P01704,
22 paragrafi 54.

23 PY. Në kuadër të këtyre hetimeve, Frank Ledwidge ka thënë që
24 është takuar me komandantin e UÇK-së, me Ismet Tarë, n që ju
25 thatë se ishte personi përgjegjës për UÇK-në. Kështu thatë,

1 apo jo?

2 PË. Po. Po. Ismet Tara ka qenë përgjegjës në Rahovec.

3 PY. A e dini ju - dhe do të jap referencën për Trupin Gjykues
4 është materiali 083217, Pjesa 11, faqja 12 - a e dini ju, pra,
5 se vetë Ismet Tara ka konfirmuar se ka folur me një hetues që
6 mund të kishte qenë nga UNMIK-u ose nga OSBE-ja dhe me këtë
7 person ka folur rreth pesë a gjashtë herë - katra-pesë herë -
8 më falni. A e dini ju këtë?

9 PË. Jo.

10 PY. Do t'ju tregoj një dokument tani.

11 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Dhe do doja që dokumenti të
12 shfaqej në ekran. Është materiali me numër SITF00389269-
13 00389271. Do doja që në ekran të vendosej faqja 3 e këtij
14 dokumenti që përfundon me 269. Do doja të shihnim paragrafin
15 7, ju lutem.

16 PY. Fatkeqësisht nuk e kemi në serbisht këtë material. Ky
17 është një raport që e ka përgatitur OSBE-ja për datën 16 deri
18 më 18 gusht të 1999.

19 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] I lutem Sekretares të shohim
20 pak datën në këtë dokument.

21 PY. Mund ta shihni këtu që është një raport i OSBE-së edhe
22 data përkatëse 16 me 18 gusht.

23 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Tani shohim paragrafin 7.

24 PY. Dua t'ju lexoj një pjesë të këtij paragrafi.

25 "Rasti më shqetësues dhe stresues në qytet javën e fundit

1 ka qenë rrëmbimi i ish-punonjësit të MVK-së, Marko Jelic. Çdo
2 përpjekje ka rezultuar e pasuksesshme për ta gjetur atë.
3 Hetimet tregojnë, sidoqoftë, se ka pasur përfshirje nga
4 Shqipëria. Ka thashetheme në qytezë që flitet për një grup që
5 ka marrë emrin "Dora e Zezë", "Banda e Dorës së Zezë".
6 Prezumohet se ky emër nëse ekziston përdoret me ironi, me
7 sarkazëm përkundrejt serbëve. Duket sikur ky grup është një
8 grup që vepron jashtë kontrollit të UÇK-së. UÇK-ja shpreh
9 keqardhjen për këtë rast...".

10 A e dini ju, pra, që ky ka qenë një konstatim i OSBE-së
11 lidhur me rrëmbimin e bashkëshortit tuaj?

12 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Kundërshtoj. Pyetja është bërë;
13 e ka marrë përgjigjen. Dëshmitarja tha që nuk dinte gjë lidhur
14 me këto hetime.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

16 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Atëherë do doja që të pranohej
17 ky dokument, ju lutem, sepse është me rëndësi për rastin tonë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

19 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Do doja që të pranohej ky
20 dokument. Ne nuk arritëm që ta pranonim këtë dokument përmes
21 Frank Ledwidge. Tani unë s'e di në ç'formë do ta kërkojmë ne
22 pranimin e këtij dokumenti. Jemi në duart tuaja.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

24 [Përkthim] S'ka asnjë rrugë për ju në këtë moment. Ajo
25 nuk mund ta identifikojë se nuk ka asnjë dijeni për këtë

1 dokument. Unë s'e di çfarë synoni të arrini ju.

2 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Problemi është që Mbrojtja
3 është cenuar në këtë rast se si rregull ky dokument mund të
4 ishte pranuar përmes z. Ledwidge. Tani z. Ledwidge s'e kemi më
5 këtu.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Znj. Tavakoli, ekziston
7 edhe mundësia që të dorëzoni një mocion për pranimin e
8 dokumenteve jo përmes dëshmitarëve.

9 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Faleminderit.

10 Z. ELLIS: [Përkthim] Kam frikë se po zbatoni një standard
11 tjetër për provat e Mbrojtjes dhe tjetër standard për provat e
12 Prokurorisë.

13 Ne na është thënë në fillim të këtij blloku të
14 dëshmitarëve që nuk ka rëndësi ndonjëherë nëse ka parë apo s'e
15 ka parë një dëshmitar përpara një dokument. Kur kundërshtuam
16 ne një rast që ishte i ngjashëm nga ana e Prokurorisë, por
17 tani do të përcaktojmë ne a përmbushen kriteret e rregullës
18 138, a është autentik dokumenti, a është *prima facie*.

19 Prima facie është absolutisht relevant, sepse lidhet me
20 personin në fjalë Marko Jelic. Edhe është autentik sepse është
21 dokument i OSBE-së. Atëherë le të zbatojmë standardet që janë
22 pranuar deri tani, e për rrjedhojë të pranohet dokumenti.

23 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Edhe ne mbështesim kolegun tonë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
25 bëni një parashtim atëherë që ta trajtojmë.

1 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Po. Dua që të pranohet ky
2 dokument për arsye që sapo citoi kolegu im.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do t'ju japim
4 një numër provizor dhe do të vendosim pak më vonë lidhur me
5 këtë.

6 Prokuroria kishte diçka për të thënë? Keni parashtrim
7 lidhur me këtë?

8 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Ne kundërshtojmë. Nuk është kjo
9 mënyra e duhur për pranimin e një dokumenti, sikurse tha dhe
10 Gjykatësi Gaynor. Mund të jetë objekt i mocionit të provave jo
11 përmes dëshmitarëve; mund ta kishin kërkuar përmes dëshmitarit
12 përkatës. Megjithatë kjo nuk është objekt për ta diskutuar
13 sot, ky muhabet.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ledwidge mund
15 të -- ka qenë këtu. Pse nuk e kërkuat ju të pranohej përmes
16 këtij dëshmitari.

17 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Po ka pas problem se paragrafi
18 54 i deklaratës së tij ka qenë e redaktuar dhe nuk na u lejua
19 të bënim pyetje për këtë.

20 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Ndonëse paragrafi ishte i
21 redaktuar në deklaratën e tij, sidoqoftë ishte diskutuar në
22 Shënimin Përgatitor numër 1 dhe mund ta kishin trajtuar në ato
23 përmes këtij shënimit përgatitor në momentin e duhur.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do t'i japim
25 një numër provizor.

Dëshmitarja: Stamena Jelic (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 35

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do të marrë numrin e
2 provës 1D192 dhe vërej se e ka klasifikimin konfidencial
3 aktualisht. Shënim -- ky është numër provizor.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

5 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

6 PY. Dua t'ju tregoj se çfarë ka thënë Frank Ledwidge për
7 bashkëshortin tuaj dhe për zhdukjen e tij dhe nuk e di a ju ka
8 thënë dhe ju të njëjtën gjë asokohe.

9 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Referenca për Trupin Gjykses
10 është dokumenti që mban numrin P0174, paragrafi 54.

11 PY. Ai tha:

12 "Duke marrë parasysh çfarë më kishin thënë për Tarën dhe
13 çfarë më tha i vetë mua, unë nuk besoj që Ismet Tara të ketë
14 patur ndonjë gisht në rrëmbimin e Jelicit apo të civilëve të
15 tjerë serbë pas futjes së NATO-s në Kosovë."

16 Frank Ledwidge ju ka ndihmuar ju dhe familjen tuaj që të
17 largoheshit nga vendi apo jo?

18 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Kundërshton. Pyetja është tepër
19 e përbërë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Zbërtheje, ju
21 lutem, në mënyrë që dëshmitarja të përgjigjet.

22 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

23 PY. Ju e njihnit Frank Ledwidge, apo jo?

24 PË. Po.

25 PY. Ai e ndihmoi familjen tuaj që të largoheshit nga Kosova,

1 apo jo?

2 PË. Po. Dhe e falënderoj. Sa i takon dokumentit siç e ka
3 thënë ai nuk kam asnjë ide, nuk kam asnjë dijeni për këtë.

4 PY. Faleminderit. Kalojmë te tema tjetër.

5 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Nxjerrim në ekran dokumentin
6 SITF00314830 deri në 00314965. Do doja të shihnim -- nuk ka
7 serbisht -- nuk ka përkthim në serbisht ky dokument. Do doja
8 që të shihnim fillimisht faqen SITF00314847.

9 PY. Ju e dini që Prokuroria Speciale e Kosovës ka kryer një
10 hetim për çështjen e bashkëshortit tuaj?

11 PË. Jo, nuk e dija këtë.

12 PY. Po hetimi është bazuar në informata që i keni dhënë dhe
13 ju vetë.

14 PË. Më lejoni të them diçka.

15 Zonjë, ne shkuam dhe raportuam zhdukjen e bashkëshortit
16 tim e asgjë më shumë.

17 PY. Unë besoj atëherë që autoritetet serbe ia ka përcjellë
18 informacionin Prokurorisë, sepse duke parë dokumentet që keni
19 ne, është e qartë se i gjithë informacioni, në një farë
20 mënyre, ka burimin nga ju. Do t'jua tregoj për një çast.

21 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Po fillimisht për të krijuar,
22 për të dhënë kontekst shohim një dokument tjetër. Shohim
23 dokumentin -- është i njëjti dokument, në fakt, po është faqja
24 SITF00 - pra, edhe një herë - SIF00314924 deri në
25 SITF00314926. Shkojmë në faqen e dytë të këtij dokumenti.

1 PY. Shohim këtu "Pretendimet faktike", titullin "Pretendimet
2 faktike", ku thuhet si ka qenë situata dhe çështja e rrëmbimit
3 të bashkëshortit tuaj. Dhe ka të njëjtat të dhëna që thatë dhe
4 ju, edhe thuhet që:

5 "Ndër rrëmbyesit Marko Jelic njohu një nga komshinjtë e
6 tyre - më falni - Stamena Jelic njohu komshinjtë e tyre
7 Filjkic dhe Bugari."

8 Pra, me sa duket hetimi është çelur në bazë të
9 informacionit që keni dhënë ju vetë.

10 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Kundërshtoj.

11 DËSHMITARJA: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Më lejoni
12 fillimisht t'ju them këtë, bashkëshorti im nuk është zhdukur
13 në '98, por është zhdukur në 1999.

14 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

15 PY. Faleminderit. E kuptojmë, është një gabim, një lapsus.

16 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Shkojmë në faqen SITF00314847.
17 Në faqen tjetër, ju lutem. Shohim paragrafin e dytë tek
18 "Arsyetimi."

19 PY. Në fakt hetuesit e kanë thënë këtë se kanë thënë që pas
20 intervistës që i kanë bërë Stamena Jelicit, e vetmja
21 dëshmitare në këtë çështje gjyqësore, ajo ka sqaruar ngjarjet
22 që kanë ndodhur në 9 gusht të '99-s, dhe tha që "jo nuk është
23 gusht i '98-s". Meqenëse lufta në Kosovë zyrtarisht përfundoi
24 më 11 qershor 1999, vepra penale u riklasifikua si krim, por
25 që nuk ishte krim lufte. Vepër penale, por jo vepër penale si

1 krim lufte".

2 Domethënë këtu ata e kanë pranuar se në fakt bashkëshorti
3 juaj është marrë në 9 gusht të '99-s. E kanë korigjuar, pra,
4 këtë gabim.

5 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] A ka pyetje?

6 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Po, pyetja është kjo:

7 Fillimisht dëshmitarja tha "është autentik [Sipas përkthimit]
8 dokumenti se e keni vitin gabim". Dhe i tregova që është
9 korigjuar data.

10 PY. Dhe gjithashtu këtu mund të shohim që ata kanë thënë se
11 të kanë intervistuar. E shihni? A e shihni ku thonë:

12 "Pas intervistës me Stamena Jelic..."

13 A ju kanë intervistuar, apo jo?

14 PË. Nuk e kuptoj kush më ka intervistuar?

15 PY. Ka qenë një -- është çelur një hetim në Kosovë nga
16 Prokuroria Speciale e Kosovës, unë ju pyeta dhe ju thatë "nuk
17 kam dijeni lidhur me këtë". A ju kujtohet që ma thatë këtë?

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shpjegojani mbase më mirë
19 këtë shkurtimin SPRK se mbase vetë dëshmitarja s'po e kupton.
20 Ne e dimë, por mbase ajo nuk e kupton për çfarë bëhet fjalë.

21 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

22 PY. Është EULEX-i, një organ i EULEX-it në Kosovë që hetonte
23 krimet. Për këtë bëhet fjalë.

24 PË. A mund të them diçka?

25 Zonjë, nuk kam bërë asnjëherë asnjë bisedë.

1 PY. Nuk keni patur asnjë bisedë me EULEX-in? Këtë po
2 deklaroni?

3 PË. Nuk kam patur asnjëherë asnjë bisedë me ata. Unë thjesht
4 kam shkuar aty dhe kam raportuar zhdukjen e burrit tim.

5 PY. A e keni raportuar zhdukjen e burrit tuaj tek organet e
6 Misionit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë?

7 PË. Po, kam shkuar te KFOR-i dhe kam raportuar për zhdukjen e
8 tij, por që atëherë askush s'më ka bërë asnjë pyetje; askush
9 nuk ka ardhur të më bëjë ndonjë pyetje. I vetmi person që na
10 nxori nga Rahoveci ishte Franku. Askush tjetër s'na ka pyetur
11 për asgjë.

12 Dhe në qoftë se mund të shtoj diçka?

13 Kam lexuar disa deklarata që janë dërguar nga autoritet
14 atje. Në një prej këtyre deklaratave thuhej që unë kam pesë
15 fëmijë. Domethënë, s'kam të bëj fare me këtë.

16 PY. Pas pak do të merremi me këtë mospërputhje, por doja të
17 kthehesha te pyetja ime.

18 Sapo konfirmuat që keni patur kontakt; keni biseduar me
19 Misionin e Bashkimit Evropian, a është kështu?

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më duket se
21 përgjigja e saj ishte që ka shkuar te KFOR-i.

22 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] KFOR-i.

23 Nëse mund të kalojmë tani te dokumenti tjetër në këtë
24 grup dokumentesh.

25 DËSHMITARJA: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po. Unë

1 vetëm thjesht kam raportuar zhdukjen e burrit tim. Askush
2 tjetër s'më ka bërë asnjë pyetje lidhur me të.

3 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

4 PY. E kuptoj.

5 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Mund të kalojmë te ky dokument
6 tani SITF00314854. Më falni, numri është SITF00314851.

7 PY. Ky është një dokument i EULEX-it në të cilin thuhet që
8 mbyllen hetimet për dy të dyshuar në lidhje me zhdukjen e
9 burrit tuaj. Emrat e tyre janë Bugari dhe Feiljkic.

10 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër pak më
11 poshtë.

12 DËSHMITARJA: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Bugari
13 është mbiemri, mbiemri.

14 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

15 PY. Faleminderit.

16 PË. Edhe diçka tjetër desha të them. Nuk e kam përmendur
17 kurrë Filjkiqin, në asnjë vend.

18 PY. Do t'ju bëj pyetje lidhur me këtë pas pak sepse ne e
19 kuptojmë që kjo është dëshmia juaj. A keni patur informacion,
20 keni qenë në dijeni që ky organ për të cilin po flasim ka
21 mbyllur hetimet për sa i përket burrit tuaj?

22 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Kundërshtim. Kjo pyetje është
23 bërë dhe ka marrë përgjigjen. Dëshmitari deklaroi që nuk ishte
24 në dijeni të hetimit.

25 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Do të doja të dorëzoja këto dy

1 faqe si prova. Në pamje të parë duken qartësisht relevante për
2 sa i përket pikës që ka të bëjë me zhdukjen e burrit të saj.
3 Konkretisht dua të dorëzoj, paraqes si provë dokumentin
4 SITF00314847 deri në SITF003314888 [Sipas përkthimit].
5 Gjithashtu dy faqe të tjerë shtesë, SITF00314851 deri në
6 SITF00314853. Baza për këtë është se janë qartësisht relevante
7 për sa i takon viktimës së vrasjes që është pjesë e kësaj që
8 është e përfshirë në këtë aktakuzë.

9 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshiron të
11 përgjigjet Prokuroria?

12 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Nuk besoj që ky dëshmitar është
13 dëshmitar i duhur për të dorëzuar këto materiale si prova. Ajo
14 deklaroi në mënyrë të qartë, në mënyrë të përsëritur që nuk
15 kishte dijeni për një hetim të tillë dhe që nuk i ka dhënë
16 deklaratë EULEX-it.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tre
18 dokumentet e përmendur pranohen. Sepse këto plotësojnë,
19 përmbushin kriteret në pamje të parë, kriteret sipas rregullës
20 138. Caktoji një numër prove materiale, ju lutem.

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Nëse mund të konfirmoj,
22 dokumentet brenda SITF00314830 deri në 00314965 RED, faqet e
23 pranuar janë 00314847 deri në 00314848 dhe 00314851 deri në
24 00314853 dhe këto faqe do të marrin numrin e provës materiale
25 1D193.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara që të
2 përfundoni me kundërpyetjet tuaja do të pranojmë dokumentin
3 1D192 që më herët ishte i shënuar për identifikim. Tani do t'i
4 japim një numër.

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Numri që do të ngelet i
6 njëjtë 1D192, thjesht do të ndërrojë statusi i provës së
7 pranuar. Do ta ndërrojmë këtë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
9 Vazhdoni.

10 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

11 PY. Dëshmitar, tani do flasim pak për Ismet Tarën. Vjehrra
12 juaj e njihte atë, apo jo? Sepse ai ishte një person i
13 respektuar në atë zonë, që gëzonte respekt?

14 PË. Po, po.

15 PY. Ju nuk shkuat me të, të nesërmen, për t'u takuar me Ismet
16 Tarën?

17 PË. Jo, jo.

18 PY. Ajo ju tregoi juve se çfarë kishte ndodhur?

19 PË. Po.

20 PË. Dhe ju i keni deklaruar, më duket MUP-it të Serbisë - dhe
21 referenca për këtë është P01700 në 030657 - që keni thënë që
22 pasi ajo ka bërë ankesën apo kërkesën ai ka thirrur aty disa
23 pjesëtarë të UÇK-së dhe i ka pyetur nëse -- dhe ka pyetur
24 vjehrrën tuaj nëse ajo i njihte ata, apo jo?

25 PË. Po.

1 PY. Ajo nuk i ka njohur, apo jo?

2 PË. Nuk i ka njohur.

3 PY. Pastaj i ka propozuar asaj që ta shoqëronte me makinë
4 nëpër qytet në përpjekje për të identifikuar personat,
5 meshkujt që i kishin bërë këtë gjë burrit tuaj. E ka bërë këtë
6 ai?

7 PË. Po.

8 PY. Ai po përpiqej të bënte -- po përpiqej të ndihmonte që
9 ajo të zbulonte se kush kishte bërë këtë gjë. Pajtoheni me mua
10 për këtë?

11 PË. Po.

12 PY. Dhe pasi u kthyen këta meshkujt në shtëpinë tuaj
13 familjare dhe ju ngacmuan, a e dini, e dinit që vjehrra juaj u
14 kthye, shkoi prapë tek Ismet Tara për të raportuar këtë gjë?

15 PË. Jo.

16 PY. Pra, ajo nuk të -- nuk ju tregoi asgjë lidhur me faktin
17 që ai kishte bërë edhe hetime të tjera shtesë lidhur me faktin
18 se kush kishte bërë atë gjë, por se nuk e dinte kush e kishte
19 bërë këtë?

20 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Referenca për këtë është 030660
21 deri në 030672 në 030663.

22 PY. A ju tregoi ajo lidhur me këtë bisedë?

23 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Kundërshtim. Pyetje e bërë dhe
24 ka marrë përgjigjen.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet

1 kundërshtimi.

2 DËSHMITARJA: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] A mund të
3 shtoj diçka?

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

5 DËSHMITARJA: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] A mund të
6 them diçka?

7 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

8 PY. Po.

9 PË. Vjehrra ime nuk mund të ecte vetë, sepse ishte e sëmurë.
10 Nuk mund të ecte nëpër Rahovec; ishte e vjetër, mbi 70 vjeç,
11 dhe përdorte një shkop, ecte me shkop. Dhe nuk është e saktë
12 kur thoni që ajo ka shkuar tek Ismet Tara disa herë.

13 Tani sa i përket deklaratës dhe kush i ka shkruar ato nuk
14 e di. S'di asgjë. Ajo ka shkuar për t'u takuar me Ismet Tarën
15 vetëm atë ditë, një herë. E di këtë sepse kemi jetuar në të
16 njëjtën shtëpi.

17 PY. Në fakt vjehrra juaj ka thënë se ka shkuar për t'u takuar
18 me Ismet Tarën dhe ajo ka thënë si në vijim, dhe dhashë
19 referencën për Gjykatën. Ajo thotë se ishte përpjekur, kishte
20 bërë pyetje, kishte kontaktuar disa komandantë, por që ai nuk
21 e dinte kush e kishte bërë këtë gjë dhe kishte arritur në
22 përfundimin se kishte gjasa që të jenë persona nga fshatrat
23 përreth dhe që dhe që ai nuk kishte më mundësi -- nuk
24 komandante më ata persona, sepse KFOR-i kishte marrë gjërat në
25 dorë.

1 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Kundërshtim. Dëshmitari deklaroi
2 se nuk e din asgjë lidhur me atë që ka ndodhur këtu edhe nuk
3 besoj që kjo pyetje është bërë më herët.

4 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

5 PY. Tani --

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet
7 kundërshtimi.

8 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

9 PY. -- pyetja që do të bëj, do të sugjeroj është që ju jeni
10 gabim dhe se nëna juaj ka thënë diçka ndryshe. Domethënë,
11 vjehrra juaj bëhet fjalë.

12 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Doja që të dorëzoj si provë
13 faqen e deklaratës --

14 DËSHMITARJA: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Zonjë, unë
15 ju thashë ju atë që më kanë thënë ajo. Tani fakti -- a ka
16 shkuar ajo që të raportojë këtë gjë në disa, disa herë tek
17 Ismeti nuk mund ta bënte një gjë të tillë. Ajo ishte grua e
18 sëmurë. Duhet ta kuptoni këtë gjë.

19 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Do të dorëzoj këtë faqe si
20 provë për të diskredituar dëshmitaren.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

22 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Kjo është kërkesa ime.

23 Dokumenti 030660 deri në 030672, faqja 030663.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

25 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Ne, qëndrimi jonë është që kjo

1 nuk është diskreditim i dëshmitares. Dëshmitarja deklaroi që
2 nuk kishte dijeni për këtë informacion dhe për rrjedhojë, ne
3 kundërshtojmë që ky dokument të dorëzohet si provë,
4 konkretisht kjo faqe e deklaratës së dëshmitarit nuk është e
5 pranishëm, nuk është aty.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kjo
7 deklaratë?

8 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Kjo është deklaratë e vjehrrës
9 së saj.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

11 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Nuk është diskreditim, por ajo
12 tha që nuk është -- ka thënë që është kthyer më shumë, ka qenë
13 aty në takim më shumë se një herë, pra. Ndërsa kjo thotë që
14 nuk mund të ecte.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prapëseprapë
16 nuk është diskreditim.

17 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Mund ta dorëzoj këtë përmes si
18 provë jogojore.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk po them
20 që nuk mund ta paraqisni si të tillë. Unë po them thjesht që
21 nuk duhet ta quajmë diskreditim sepse nuk është, apo
22 diskredituese.

23 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Gjykatës, kjo faqe

1 konkretisht do të marrë numrin 1D194.

2 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Nga sistemi juridik gjyqësor ku
3 vij unë këto janë termat që -- të panjohur për mua. Për këtë
4 po luftoj pak po me termin "diskreditim". Nuk kemi të njëjtën
5 proces.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

7 [Përkthim] Kjo është edhe një vlerësim -- vlerësim është
8 edhe fakti që nëse bëhet fjalë për deklaratat apo jo dhe ne
9 kemi arsye për ta shënuar atë si dokument që pritet të
10 identifikohet për ta shqyrtuar më tej pikërisht.

11 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Faleminderit.

12 PY. Tani do doja që të kaloj te tema e parafundit.

13 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Më duhet pak më shumë kohë nga
14 ç'kisha parashikuar.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

16 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Kisha rezervuar një orë që e
17 kam plotësuar tashmë. Mund të më duhet pak më shumë kohë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

19 Vazhdoni.

20 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Në qoftë se mund të shfaqim në
21 ekran tani dokumentin që nuk duhet t'i tregohet ndoshta
22 publikut. Dokumenti i parë është 030655 deri në 030659 dhe ka
23 të njëjtën referencë në serbisht. Faqja që na intereson është
24 030658. Dhe tani shohim në fund të faqes, mund të kalojmë në
25 fund të faqes.

1 PY. Këtu kemi një fjali që fillon:

2 "Përpara që ushtria dhe policia të largoheshin, të iknin
3 nga Kosova, babai im dhe vjehrra ime shkuan dhe bënë vizitë te
4 disa fqinjë shqiptarë. Ndërsa aty -- edhe po shihja një
5 fotografi në të cilin burri im Marko mbante një armë."

6 A e shihni këtë deklaratë, këtë fjali?

7 PË. Po.

8 PY. Javën e kaluar kur keni biseduar me Prokurorin - dhe
9 referenca është Shënimi Përgatitor 1, paragrafi 16 - ju thatë
10 që nuk keni thënë këtë fjali lidhur me fotografinë në të cilën
11 burri juaj Marko shihej duke mbajtur një armë. A ju kujtohet
12 kjo?

13 PË. Po, nuk e kam thënë këtë; nuk e kam deklaruar që ata e
14 kanë bërë një fotografi të tillë; s'e kam parë asnjëherë,
15 kurrë këtë gjë.

16 PY. Që kanë parë një fotografi. Është përkthimi i duhur, i
17 saktë?

18 PË. Jo, nuk më kujtohet kjo. Nuk më kanë thënë këtë gjë.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

20 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

21 PY. Që të jemi tërësisht të qartë, ajo që po thoni ju është
22 që nuk keni thënë asnjëherë në asnjë moment që kur babai juaj
23 dhe vjehrra juaj ishin aty kanë parë një fotografi, a është
24 kjo ajo që po thoni? Këtë gjë nuk e keni thënë?

25 PË. Nuk e kam thënë këtë gjë. Por nuk e di nëse kam parë apo

1 jo diçka. Ata as më kanë thënë asgjë, unë nuk di asgjë për
2 këtë.

3 PY. A jeni dakord me mua që në këtë deklaratë këtu thuhet që
4 ju keni thënë se ata kanë parë një fotografi?

5 PË. Po këtë e shoh këtu, por nuk e kam thënë këtë, nuk më
6 kujtohet ta kem thënë.

7 PY. E shihni nënshkrimin tuaj në fund të deklaratës?

8 PË. E shoh, por kjo nuk është deklarata ime. Unë e di shumë
9 mirë atë që kam thënë. Kjo nuk është diçka që e kam thënë unë.

10 PY. A duhet të mendoj që në momentin që keni nënshkruar këtë
11 deklaratë kjo fjali nuk gjendej në këtë deklaratë?

12 PË. Saktë, saktë. Unë nuk kam përmendur fare asnjë fotografi
13 dhe asgjë që vjehrra më ka thënë mua.

14 PY. Mendoj që kjo deklaratë ka qenë --

15 PË. Dhe këto deklaratë -- këto emra që janë këtu, jo. Nuk
16 është deklarata ime kjo.

17 PY. A mund t'i hidhni një sy pak mbi pjesës sipër së
18 nënshkrimit ku lexon:

19 "Kjo deklaratë përmban të vërtetën" dhe thotë "pranoj
20 deklaratën si timen, pranoj që deklarata më është lexuar dhe
21 është e imja dhe e nënshkruaj atë."

22 PË. Po, e shoh këtë, zonjë. Megjithatë kjo nuk është
23 deklarata ime. Dhe këto emra aty që janë Avni Bala e të tjerë,
24 nuk janë të miat.

25 PY. Pra, nuk jeni në gjendje të na thoni se si kjo fjali ka

1 hyrë në deklaratën tuaj? Se si përfundoj aty?

2 PË. Jo.

3 PY. Në të njëjtën faqe të kësaj deklarate thuhet --

4 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Në qoftë se mund ta shfaqni
5 pjesën më sipër pak. Një sekondë sa po përpiqem ta gjej. Pak
6 më poshtë.

7 PY. Në fund të këtij paragrafi që trajtuam aty thuhet:

8 "Personalisht besoj që personi që ka -- përgjegjës për
9 pas rrëmbimit të burrit tim është Avni Bala dhe një, dhe
10 fqinjët shqiptarë të cilët i kam përmendur dhe që e kanë marrë
11 nga shtëpia."

12 E shihni këtë pjesë?

13 PË. E shoh, por, zonjë, unë nuk e kam thënë këtë; nuk e kam
14 përmendur atë dhe apo dikë tjetër si organizues i kësaj gjeje.

15 PY. Po ju e keni nënshkruar këtë deklaratë. Shihet nënshkrimi
16 -- ju shihni nënshkrimin tuaj në fund të faqes.

17 PË. E shoh, por këto nuk janë deklaratat e mia.

18 PY. A po na thoni që momentin kur ju e keni nënshkruar atë,
19 kjo fjali nuk gjendej në deklaratë, nuk ishte aty?

20 PË. Personat që i kanë shkruar këto deklarata duket që kanë
21 improvizuar, nuk e di si e kanë shkruar. Por unë s'i kam
22 përmendur këta emra Avni Bala apo të tjerë. Unë s'i kam
23 përmendur kurrë.

24 PY. Kjo deklaratë është përpiluar nga MUP-i serb. I dini këto
25 gjë? Në krye të faqes thuhet që është deklaratë që ju i keni

1 dhënë MUP-it serb. A është kështu?

2 PË. E shoh atë që është e shkruar aty, po e lexoj. Por këto
3 nuk janë fjalët e mia.

4 PY. Pak më herët thatë që kjo ishte -- kushdo që e ka shkruar
5 këtë ka improvizuar në një mënyrë. A jeni duke dëshmuar që
6 MUP-i serb ka improvizuar kur ka bërë këtë gjë?

7 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Kundërshtoj. Është spekulim dhe
8 këto dy fjalë, konkretisht që iu lexuan dëshmitarit janë
9 sqaruar në Shënimin Përgatitor 1, që është prova P01703,
10 paragrafi 16 dhe këto dy fjali në veçanti janë qartësuar
11 sqaruar nga dëshmitari.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.
13 Mund t'i përgjigjeni pyetjes.

14 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

15 PY. Znj. Dëshmitare, ju thatë që kushdo që të ketë qenë
16 personi që ka marrë këtë deklaratë ka improvizuar aty. Ne e
17 dimë që këtë deklaratë e ka marrë MUP-i serb dhe që kjo është
18 qëndrimi juaj, pra, që MUP-i serb ka improvizuar aty?

19 PË. Unë thjesht dua të them që këto nuk janë fjalët e mia,
20 asgjë më tepër.

21 PY. Në të njëjtën deklaratë --

22 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Kemi edhe një incident në të
23 njëjtën deklaratë. A mund të vazhdoj?

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

25 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

1 PY. Tani a vazhdojmë -- jemi akoma me këtë deklaratë. Faqja
2 657. Pra, faqja përpara kësaj. Këtu thuhet --

3 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Pak më poshtë, ju lutem.

4 PY. Këtu paragrafi i katërt, ku fillon: "Në gusht..." E shikoni
5 këtë? Dhe pastaj nga mesi lexon:

6 "Më kujtohet se njëri prej tyre e kishte mbiemrin Siljkiq,
7 i dyti Bugari dhe i treti kishte veshur pantallona të shkurtra
8 dhe këpucë, dhe kishte pseudonimin Golubar."

9 E shikoni këtë pjesë?

10 PË. Sa i takon Golubarit dhe Bugarit nuk e kam thënë këtë gjë.
11 Dhe pjesën tjetër -- sa i përket Golubarit dhe Gubarit e kam
12 thënë, ndërsa pjesën tjetër, jo.

13 PY. Tamam këtë po thoja.

14 PË. Dhe deklaratën në këtë pjesë:

15 "Pjesa në korrik..." aty.

16 PY. Faleminderit. Javën e kaluar i keni thënë Prokurorit në
17 paragrafin 8, Shënimi Përgatitor 1 që nuk e keni përmendur
18 Siljkiqin fare, a është kështu?

19 PË. Po.

20 PY. Gjykata, Trupi Gjykues mund të shohë se emri është shënuar
21 këtu në deklaratë, apo jo? Është aty.

22 PË. Dëgjoni, ka shumë gjëra të shënuara këtu që të ndryshme që
23 nuk i kam thënë. Këtu thuhet po ashtu që Hashim Thaçi kishte
24 ardhur në Rahovec. Nuk e kam thënë këtë, sepse është diçka që do
25 ta kujtoja, do të më kujtohej.

Dëshmitarja: Stamena Jelic (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 53

1 PY. Znj. Dëshmitare, ju thoni që kur e keni nënshkruar këtë
2 deklaratë këto elementë nuk gjendeshin në deklaratë. A është
3 kështu?

4 PË. Unë thjesht po them që kjo nuk është një diçka që e kam
5 thënë; nuk e kam thënë.

6 PY. E keni nënshkruar deklaratën apo jo?

7 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Kundërshtim. Pyetja është bërë dhe
8 është marrë përgjigja.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

10 [Përkthim] Rrëzohet.

11 Mund t'i përgjigjesh pyetjes, Dëshmitare.

12 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

13 PY. E keni nënshkruar këtë deklaratë?

14 PË. Nuk e di përgjigjen, nuk e di. Ajo që po lexoj këtu në
15 ekran nuk është diçka që e kam thënë. S'kam thënë asgjë prej
16 këtyre.

17 PY. Në qoftë se zbresim e shohim më poshtë tek pjesa e
18 nënshkrimit, në faqen tjetër, e shihni këtu nënshkrimin tuaj?

19 PË. Po, e shoh, por nuk kam thënë asgjë prej këtyre që janë
20 këtu.

21 PY. Kur keni nënshkruar deklaratën, a e keni nënshkruar duke
22 menduar, besuar, që ajo përmbante të vërtetën?

23 PË. Zonjë, unë e kuptoj pyetjen tuaj, por asgjë, asnjë gjë
24 nga këto që janë këtu nuk janë fjalët e mia, nuk e kam thënë
25 as gjysmën e këtyre që janë këtu. Pra, nuk e kuptoj fare. Nuk

1 e kuptoj me të vërtetë se nga vijnë të gjitha këto gjëra.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Kam një pyetje për ju:
3 Cili është qëndrimi juaj, çfarë po përpiqeni të vërtetoni
4 këtu, a po pyesni dëshmitarin që nëse ka thënë këtë dhe tani
5 po e mohon apo po thoni që dikush tjetër i ka shkruar këto
6 gjëra aty?

7 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Po përpiqem të analizojmë, të
8 zbulojmë më shumë, sepse ajo e ka nënshkruar këtë gjë. Ajo
9 thotë që e ka nënshkruar por që nuk ka thënë këto gjëra që
10 përmban deklarata. Pra, po përpiqem të kuptoj se si kanë
11 përfunduar këto gjëra në deklaratë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është e qartë
13 që ajo nuk e din se nga kanë ardhur këto gjëra dhe si kanë
14 përfunduar në deklaratë.

15 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]
16 PY. Ky është edhe shembull tjetër i MUP-it, që kur në rastet
17 kur MUP-i bën improvizime, pra.

18 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Kundërshtim. Ky është spekulim;
19 na çon drejt spekulimit.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

21 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Mund të bëjmë pushimin tani.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë
23 pushimin tani.

24 Do të marrin gjysmë ore pushim, Dëshmitare. Do të
25 kthehemi në sallën e gjyqit pas -- në 11:10 ose 20 minuta

Dëshmitarja: Stamena Jelic (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 55

1 pushim dhe do rifillojmë në orën 12.

2 [Dëshmitarja përfundon dëshminë përmes
3 videolidhjes]

4 --- Pauza fillon në orën 11.07

5 --- Seanca rifillon në orën 11.39

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sa i takon
7 caktimit të numrave provizorë të provave, sa i takon ID194
8 [Sipas përkthimit], dokument i cili qartazi është një
9 deklaratë e një pale të tretë, duhet të ishte paraqitur --
10 duhet të ishte kërkuar që të regjistrohej si provë sipas
11 rregullave 134, 135 -- 54 dhe 55 dhe standardi ishte ai.

12 Ndërkohë që sa i takon materialit në këtë deklaratë ai
13 përdoret për çështje që kanë të bëjnë me besueshmërinë dhe që
14 janë lexuar në seancë të hapur. Dëshmia e dhënë nga dëshmitari
15 dhe pjesa që lidhet me procesverbalin e saktë dhe dëshminë e
16 saj nuk ka të bëjë me këtë dokument, kështu që si rezultat nuk
17 do pranohet si provë. Është deklaratë e vjehrrës së
18 dëshmitarit dhe si rezultat nuk është deklaratë e
19 drejtpërdrejtë e saj kështu që nuk do të pranohet si provë.
20 Kjo ka të bëjë me faqen 030663.

21 Ju lutem silleni dëshmitarin në sallë.

22 [Dëshmitarja vijon dëshminë përmes
23 videolidhjes]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, na
25 dëgjoni?

1 DËSHMITARJA: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

3 Tani do të vazhdojmë më tej me dëshminë tuaj. Znj.

4 Tavakoli ka ende disa pyetje. Është avokate e z. Thaçi. Ju

5 lutem dëgjojeni me vëmendje.

6 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Faleminderit.

7 PY. Keni dhënë një deklaratë në vitin 2002 për SUP-in e

8 Krushevaçit, të cilën do i kërkoja Sekretares tani ta

9 paraqiste në ekran.

10 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Për procesverbal është

11 dokumenti P01699. Dua që të shfaqet në ekran faqja 030669. Ju

12 lutem paraqisni versionin në serbisht dhe në anglisht në të

13 njëjtën kohë, dy dokumente përbri njëra-tjetrës.

14 DËSHMITARJA: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Në rregull.

15 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim]

16 PY. A e shihni këtë rreshtin në fillim ku thuhet:

17 "Bashkëshorti im është rrëmbyer me udhëzimet e Avni

18 Balës, Nazif Shabanit, Shkurt [Sipas përkthimit] Miftarit dhe

19 Arsim Dërgutit."

20 A e shikon, a e lexon këtë fjali, Dëshmitar?

21 PË. Po, e shoh.

22 PY. A e dalloni nënshkrimin tuaj në fund të kësaj faqeje?

23 PË. Po, e shikoj dhe atë.

24 PY. Dhe fjala që është sipër nënshkrimit tuaj lexon si më

25 sipër:

1 "Kjo është një deklaratë e cila më është lexuar dhe është
2 deklarata ime. Unë e pranoj këtë deklaratë dhe duke qenë
3 kështu jap nënshkrimin tim lidhur me të."

4 E lexon këtë, Dëshmitar?

5 PË. Po, e shoh.

6 PY. Gjatë seancë përgatitore përpara një javë, dhe referencë
7 për këtë është Shënimi Përgatitor 1, paragrafi 18 - ju keni
8 thënë që nuk keni thënë asnjëherë që bashkëshorti juaj është
9 rrëmbyer me udhëzimet e këtyre personave që përmendet më herët
10 ose me urdhër të tyre. A ju kujtohet ta keni thënë këtë,
11 dëshmitar?

12 PË. Po, më kujtohet. Më kujtohet që e kam thënë këtë sepse e
13 kam korrigjuar këtë pjesë të deklaratës sepse nuk i kam
14 përmendur asnjëherë këto emra.

15 PY. Kur e keni nënshkruar këtë deklaratë që e keni në ekran,
16 kjo fjalia ka qenë aty në versionin që e keni nënshkruar ju?

17 PË. Singërisht nga këta emra dhe këto fjalë, unë nuk kam
18 përmendur asgjë. Nënshkrimi është i imi, megjithatë fjalët nuk
19 janë të miat.

20 PY. Nuk ishte kjo në fakt pyetja ime. Pyetja ime ishte pak
21 ndryshe. Pyetja ime ishte kjo: Kur e keni nënshkruar këtë
22 deklaratë, kjo fjalia ka qenë pjesë e dokumentit që keni
23 nënshkruar ju?

24 PË. Jo, ndoshta, nuk e di, nuk më kujtohet. Megjithatë,
25 pavarësisht të gjithave këto nuk janë fjalë që kam thënë unë.

1 PY. Nuk ishte pyetja ime përsëri, megjithatë mendoj që e
2 morëm idenë.

3 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Tani do i kërkoja Sekretares të
4 paraqesë në ekran dokumentin e radhës që është P01702, që
5 është një procesverbal i intervistës që keni dhënë juve
6 përpara Gjykatës -- gjykatësit të procedurës paraprake të
7 Dhomës së Krimeve të Luftës në Gjykatën e Lartë të Beogradit.
8 Shohim faqen që përfundon me 486 në këtë dokument. Të shkojmë
9 në fund të faqes, nëse është e mundur.

10 PY. Këtu fjalialia e parafundit thotë:

11 "Me këtë rast, Bugari erdhi dhe na kërkoi që t'i jepnim
12 20 ose 30 mijë marka për ta lënë të lirë bashkëshortin tim,
13 por ne i thamë që nuk i kishim aq para."

14 A e shihni këtë?

15 PË. Po, e shoh, dhe herën e fundit e kam korrigjuar këtë
16 pjesë. Ata kanë kërkuar para por nuk kanë kërkuar një sasi
17 konkrete parash.

18 PY. A e shikoni nënshkrimin tuaj në fund të kësaj faqeje?

19 PË. E shoh.

20 PY. Këto janë fjalët që -- mbi nënshkrimin tuaj. Pra, thuhet
21 që:

22 "E kam lexuar këtë procesverbal që më është lexuar. Kjo
23 është dëshmia ime dhe e jap nënshkrimin tim pa kundërshtim."

24 Dhe pastaj shohim nënshkrimin tuaj. A është e saktë kjo,
25 Dëshmitar?

Dëshmitarja: Stamena Jelic (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Tavakoli

Faqe 59

1 PË. Po.

2 PY. Kur e keni nënshkruar këtë dokument ju keni konfirmuar se
3 ai është i vërtetë, apo jo? A është e drejtë të thuhet që kur
4 e keni nënshkruar këtë dokument ju keni thënë ose keni
5 vërtetuar që është i saktë, apo jo?

6 PË. E saktë.

7 PY. A është dëshmia juaj kjo që kur keni nënshkruar këtë
8 dokument kjo fjali nuk ka qenë aty, domethënë kjo hollësia
9 lidhur me 20 ose 30 mijë markat nuk kanë qenë aty kur keni
10 nënshkruar dokumentin. Këtë po thoni tani, Dëshmitar?

11 PË. E kam thënë dhe më përpara dhe po e them përsëri, ky
12 personi, Bugari, ka kërkuar para por nuk është se ka
13 përmendur, nuk ka thënë dua 20 ose 30 mijë marka.

14 PY. Nuk është pyetja ime tamam kështu. Pyetja ime është kjo?
15 Kur e keni nënshkruar këtë dokument, dokumenti a e kishte këtë
16 fjalinë që thuhet që ai ka kërkuar 20 apo 30 mijë marka? Po
17 apo jo?

18 PË. Nuk më kujtohet.

19 PY. Domethënë ka -- kemi numëruar deri tani pesë herë ku ju
20 keni nënshkruar dokumente që përmbajnë fjali që ju thoni që
21 nuk i keni thënë. A është e saktë kjo?

22 PË. Po.

23 PË. A mund të na ndihmoni e të na thoni se si kanë përfunduar
24 këto fjali në dokumentet tuaja?

25 ZNJ. INSIGA: [Përkthim] Kundërshtoj, kërkon spekulim.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzon, në
2 qoftë se e di dëshmitari mund të përgjigjet.

3 DËSHMITARJA: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Singerisht
4 nuk e di. Ato çfarë ju thatë ju qëndroj pas atyre çfarë
5 thashë. Ato që thashë që nuk i kam thënë, nuk i kam thënë.

6 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit.
7 PY. Kam një pyetje tjetër. Është një pyetje që ka të bëjë me
8 një temë tjetër. A e kam kuptuar drejtë që ju thoni që KFOR-i
9 nuk ka bërë një punë veçanërisht të mirë për të gjetur burrin
10 tuaj ose për të hetuar lidhur me zhdukjen e tij?

11 PË. I qëndroj kësaj që ata nuk kanë bërë asgjë dhe kaq.

12 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
14 znj. Tavakoli.

15 Znj. Rowan.

16 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Nuk kemi pyetje.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts.

18 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kemi pyetje.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis.

20 Z. ELLIS: [Përkthim] Po, faleminderit. Për arsye
21 planifikimi, planifikoj që do më duhen më pak sesa gjysmë ore.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

23 Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis:

24 Z. ELLIS: [Përkthim]

25 PY. Dëshmitar, unë quhem Aidan Ellis, dhe jam avokati i Jakup

1 Krasniqit. Do filloj me disa pyetje që kanë të bëjnë me këtë
2 personin me emrin Bugari që ju thatë që është një ndër
3 personat që ka ardhur në shtëpinë tuaj me 9 gusht 1999. I keni
4 thënë Prokurorisë në seancë përgatitore të organizuar më herët
5 këtë muaj, për procesverbal është prova 1703, paragrafi 15, që
6 ju nuk e dini se si quhet ai, si quhet ky person, pra. A ju
7 kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

8 PË. Po, po.

9 PY. Bugari është një mbiemër i zakonshëm në zonën e
10 Rahovecit, apo jo?

11 PË. Nuk e di.

12 PY. Në rregull. Megjithatë i keni thënë Prokurorit që ju këtë
13 person, me mbiemrin Bugari, e njihnit sepse jetonte poshtë
14 shtëpisë tuaj, kështu? E saktë?

15 PË. Po.

16 PY. A ju tregoi fotografi ZPS-ja në mënyrë të tillë që ju të
17 mund të identifikonit personin që ju thoni që e ka mbiemrin
18 Bugari përmes fotografive?

19 PË. Jo.

20 Z. ELLIS: [Përkthim] Të shohim së pari dokumentin
21 SITF00314830 në faqen SITF00314875. Faqja 310875.

22 PY. Dëshmitar, është vetëm në anglisht, kështu që do të më
23 duhet të lexoj pjesët për të cilat dua t'ju bëj pyetje. Pra,
24 është një kërkesë autoriteteve të EULEX-it, ja u bënë pyetje
25 më herët sot paradite lidhur me EULEX-in, pra është një

1 kërkesë që dërgohet nga EULEX-it për autoritetet serbe dhe
2 është një dokument që mban datën e shkurtit 2014. Kërkohet që
3 të intervistoheni ju si dëshmitare. Dhe një ndër gjërat që ju
4 -- që kërkohet që juve të jepni përgjigjet tuaj, ka të bëjë me
5 numrin 5 që është në këtë dokument, dhe pyetja ka të bëjë në
6 qoftë se do ishit në gjendje që të identifikonit personit
7 lidhur me atë kohë, pra autorët e veprave dhe këto -- këtë
8 identifikim personash të mund të bënit duke parë fotografitë.

9 Ju e keni parë këtë intervistë, ju e keni parë këtë
10 intervistë nga autoritetet serbe në prill 2014, apo jo?

11 PË. Po.

12 Z. ELLIS: [Përkthim] Atëherë mund të paraqitet në ekran
13 intervista, domethënë teksti i intervistës që është prova e
14 pranuar tanimë me numër P1702. Më përpara ka pasur numrin
15 SIT00314867.

16 PY. Në fillim të kësaj faqeje, paragrafi i parë lexon si më
17 poshtë:

18 "E përpiluar më 1 prill 2014, përpara gjykatësit të
19 procedurës paraprake të Dhomës së Krimeve të Luftës në
20 Gjykatën e Lartë të Beogradit, pas një kërkesë të EULEX-it me
21 datë 4 [Sipas përkthimit] shkurt 2014 për intervistimin e një
22 dëshmitari."

23 Nëse e kuptoj drejt çfarë ka ndodhur është kjo që EULEX-i
24 ka bërë një kërkesë për intervistimin tuaj dhe pastaj
25 intervistimi juaj ka ndodhur në Beograd rreth dy muaj më pas.

1 A është kështu, Dëshmitar?

2 PË. Mundet, po nuk më kujtohet. Singërisht nuk më kujtohet.

3 PY. E kuptoj. Gjatë kësaj interviste një prej gjërave që ju
4 kanë pyetur dhe ti ke thënë që:

5 "...pa diskutim që do i njihja këta persona në qoftë se
6 do i shihja përsëri."

7 Dhe më pas, dhe kjo jepet në faqen e tretë:

8 "...E theksoj që do i njihja të gjithë në qoftë se do i
9 shikoja prapë."

10 Pra, në 2014-n ju thoni që do i njihnit personat që janë
11 futur në shtëpinë tuaj me 9 gusht në qoftë se do i shikonit
12 përsëri. Këtë keni thënë?

13 PË. Po, po, këtë kam thënë, sepse ata nuk kishin maska të
14 vëna në fytyrë, nuk ishin të fshehur.

15 PY. Megjithatë askush nuk ju ka treguar juve asnjë fotografi
16 dhe nuk ju ka pyetur në qoftë se mund të njihni të caktuar në
17 atë fotografi, apo jo?

18 PË. Jo, jo, nuk më kanë treguar. Asnjëherë nuk më kanë
19 treguar asnjë fotografi.

20 Z. ELLIS: [Përkthim] Në rregull, do të kalojmë te një
21 temë tjetër. Mund të hiqet ky dokument nga ekrani dhe në vend
22 të tij do i kërkoja Sekretares që të paraqitej dokumenti
23 DJK01041.

24 PY. Përsëri, Dëshmitar, është një dokument i cili është i
25 disponueshëm vetëm në anglisht megjithatë pjesët përkatëse do

1 t'jua lexoj. Keni thënë që vjehri juaj ka qenë në shtëpinë
2 tuaj në gusht të vitit 1999. Domethënë me 9 gusht. Ai quhej
3 Dragomir Jelic, apo jo?

4 PË. Po.

5 PY. Dokumenti që po paraqitet tani në ekran është nga paneli
6 këshillimor i të drejtave të njeriut të UNMIK-ut, dhe titulli
7 i dokumentit është: "Dragomir Jelic kundër UNMIK-ut". A jeni
8 në dijeni që vjehri juaj ka bërë një ankesë kundër UNMIK-ut
9 sa i takon trajtimit të rrëmbimit të djalit të tij ose të
10 bashkëshortit tuaj?

11 PË. Jo, nuk jam në dijeni të kësaj.

12 PY. Në rregull.

13 Z. ELLIS: [Përkthim] Tani të kalojmë tek faqja DJK01045.

14 PY. Do t'ju lexoj pjesë të paragrafit 20 dhe 21.

15 Paragrafi 20:

16 "Ankimuesi është babai i Marko Jeleniç [Sipas
17 përkthimit]".

18 Paragrafi 21 thotë që:

19 "Ankimuesi thotë që me 9 gusht 1999 djali i tij u rrëmbye
20 nga shtëpia e familjes në Rahovec nga tre shqiptarë të
21 armatosur në praninë e të gjithë familjes, përfshirë këtu edhe
22 bashkëshortes së Marko Jelic dhe të dy fëmijëve të tyre të
23 mitur."

24 Do ndaloj këtu. Pra, pa diskutim që këtu bëhet fjalë për
25 rastin e bashkëshortit tuaj, apo jo, Dëshmitar?

1 PË. Po, po për këtë nuk kam dijeni.

2 PY. Në rregull. Tani do t'ju lexoj një tjetër paragraf të
3 këtij dokumenti.

4 Z. ELLIS: [Përkthim] Të shkojmë në dokumentin DJK00163.
5 Në paragrafin 104 të këtij dokumenti.

6 PY. Përsëri do t'jua lexoj përmbajtjen e këtij dokumenti:

7 "Trupi Gjykses vëren se megjithëse dosja hetimore tregon
8 që WCIU-ja", që duhet të ketë qenë Njësia për Krimet e Luftës,
9 "ka përfunduar një raport hetues pas vdekjes në mars 2005, nuk
10 konstatohet që janë ndërmarrë hapa bazë hetuese nga policia e
11 UNMIK-u, përfshirë këtu edhe vizita në shtëpinë e tij në
12 Rahovec, vendin ku z. Marko Jelic ka -- është parë për herë të
13 fundit, ose për të mundur që të kuptohet pak më mirë
14 rrethanat e zhdukjes së tij ose identifikimit të individëve
15 përmes intervistave që banojnë në zonën e krimit të
16 pretenduar. Nuk ka dëshmi që policia e UNMIK-ut është
17 përpjekur që të kontaktojë me ankimesin ose me ndonjë anëtar
18 tjetër të familjes së vet që kanë qenë dëshmitarë të
19 rrëmbimit. Ngjashëm nuk konstatohet nga dosja që policie e
20 UNMIK-ut është përpjekur të gjejë dhe të intervistojë z. B ose
21 z. F, që janë persona që Stamena Jelic kanë thënë që kanë
22 rrëmbyer bashkëshortin e saj."

23 Pyetja për ju është kjo: A keni qenë në dijeni të faktit
24 që policia e UNMIK-ut nuk është përpjekur që të gjejë vendin
25 ku ndodheshin ose intervistonin persona që ju pretendoni që ju

1 kanë rrëmbyer bashkëshortin tuaj?

2 Z. INSINGA: [Përkthim] Kundërshtoj, spekulon.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

4 DËSHMITARJA: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Ju kërkoj
5 ndjesë, por nuk di asgjë lidhur me këtë.

6 Z. ELLIS: [Përkthim]

7 PY. Në rregull. E kuptojmë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

9 Të nderuar Gjykatës, kërkoj pranimin e dokumentit. Parashtroj
10 që ky dokument i pranon -- i përmbush kriteret e rregullës
11 138.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
13 kundërshtim?

14 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Jo.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
16 [Përkthim] E doni që të pranohet i gjithë dokumenti?

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Po, do preferoja që i gjithë
18 dokumenti, në të gjitha faqet të mund të pranohet.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
20 na jep numrin DJK.

21 Z. ELLIS: [Përkthim] Është DJK01041 deri në 10475 [Sipas
22 përkthimit].

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përderisa nuk
24 ka kundërshtime dokumenti DJK01041 deri në 1075 pranohet.

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do

1 të marrë numrin e provës 4D85. Ju lutem na thoni klasifikimin.

2 Z. ELLIS: [Përkthim] Klasifikimi është publik.

3 PY. Tani do të kalojmë në një temë tjetër, Dëshmitar. Sot
4 paradite ju bënë disa pyetje lidhur me kartën blu të
5 identitetit që disa persona ja u treguan ju. Pyetja për ju
6 është kjo: A ju janë treguar disa lloje të ndryshme të kartave
7 të identitetit për të qenë në gjendje që të identifikoni ose
8 të dini ose që të shikoni që bëhej fjalë për karta të
9 ndryshme?

10 PË. E thashë dhe më përpara që më është treguar vetëm një
11 kartë. Personi që ma tregoi këtë kartën, pra që ma tregoi këtë
12 kartën e identitetit nuk ishte nga aty, nga zona, nga
13 Rahoveci. Ishte nga diku tjetër sepse as serbisht nuk fliste
14 fare.

15 PY. Pyetja ime është kjo - ndoshta nuk ja u bëra qartë
16 pyetjen, por po e përsëris dhe një herë. Gjatë hetimit të
17 këtij rasti - pyetja ime është kjo: A ju janë treguar shembujt
18 të disa kartave të identitetit në mënyrë të tillë që ju të
19 kishit mundësi që të thonit që kjo është karta që më kanë
20 treguar atëherë?

21 PË. Nuk e kuptoj pyetjen. Kush më ka treguar?

22 PË. Hetuesit që të kanë bërë pyetje lidhur me zhdukjen e
23 bashkëshortit. Ndonjë prej hetuesve a ju ka treguar disa raste
24 ose disa shembuj të kartave të identitetit?

25 PË. Jo, jo.

1 PY. Kalojmë në një temë tjetër.

2 Z. ELLIS: [Përkthim] Shohim në ekran, ju lutem,
3 materialin që ka numrin 2 -- 027628. Ballinën fillimisht. Ka
4 dhe një përkthim në anglisht që mban numrin DJK01076.

5 PY. Paraprakisht do ju kërkoj falje për shqiptimin e emrit.
6 Ballina e këtij libri është "Monument për vuajtjet e Kosovës
7 së Re", nga "Metropali Radoviç". E keni parë ndonjëherë më
8 përpara këtë libër?

9 PË. Jo.

10 PY. Po autori Metropolitan Amfilohija a është një prift i
11 lartë, i rangut të lartë në kishën Ortodokse?

12 PË. Nuk e kuptoj pyetjen tuaj. Çfarë lidhje ka Metropolitan,
13 peshkopi me pyetjet e mia, me çështjen time, më falni.

14 PY. Mirë atëherë.

15 Z. ELLIS: [Përkthim] Shohim faqen 027978 në serbisht dhe
16 tek anglishtja duhet të jetë faqja e dytë.

17 PY. Dua t'ju tregoj një fragment të këtij libri. Është në
18 krye të faqes. Thotë "Marko Jelic, 31 vjeç, një ekonomist na
19 Rahoveci në Termovent, u rrëmbye më 20 qershor pa nam e pa
20 nishan. E morën nga shtëpia tre shqiptarë të armatosur në
21 veshje civile, rreth 30 vjeç, thanë që do ta merrnin për
22 intervistë dhe se do të kthehej menjëherë."

23 Tani pyetja ime është kjo: Ju personalisht apo anëtarë të
24 familjes tuaj a i keni dhënë informacione kishës Ortodokse
25 lidhur me rastin e bashkëshortit tuaj?

1 PË. Jo.

2 PY. Po është e qartë që banorët e Rahovecit kanë folur
3 menjëherë sapo ka ndodhur kjo edhe filluan të dilnin variante
4 të ndryshme të kësaj ngjarjeje, apo jo?

5 PË. E kuptoj pyetjen tuaj, zotëri. Po pikësëpari bashkëshorti
6 im nuk është zhdukur në qershor po më 9 gusht. Se kush i ka
7 thënë dhe çfarë ka thënë, unë nuk e kuptoj se çfarë lidhje ka
8 kjo me mua apo me familjarët e mi.

9 Z. ELLIS: [Përkthim] Shohim një dokument tjetër atëherë.
10 Mban numrin SPOE00105525.

11 PY. Kjo është në anglisht, por unë do t'ju lexoj pjesët
12 përkatëse. është një dokument i Kryqit të Kuq Ndërkombëtar,
13 ky. A ka qenë Kryqi i Kuq Ndërkombëtar një prej organizatave
14 që keni kontaktuar ju pas zhdukjes së bashkëshortit tuaj?

15 PË. Jo.

16 Z. ELLIS: [Përkthim] Të shkojmë në faqen e dytë. Më
17 poshtë në tekst.

18 PY. Në dokument thuhet që më 6 qershor 2002:

19 "Është bërë një kërkesë nga Kryqi i Kuq Ndërkombëtar nga
20 Jelic Stamina [Sipas përkthimit] (bashkëshortja)."

21 Pra mund të keni bërë ju -- a ka mundësi të keni
22 depozituar një kërkesë për gjurmimin pranë Kryqit të Kuq
23 Ndërkombëtar, ju, në 2002 më 6 qershor?

24 PË. S'i kam dhënë ndonjëherë deklaratë atyre, as nuk kam
25 shkuar t'i takoj. Ka qenë kunata, motra e Markos që ka shkuar.

1 PY. Në rregull.

2 Z. ELLIS: [Përkthim] Shkojmë pak më lartë në këtë faqe
3 dhe do t'ju lexoj një paragraf ku thuhet:

4 "Sipas informacionit që kanë dhënë familjarët, dëshmitarë
5 okularë të ngjarjes në fjalë, më 9 gusht 1999, në orët e
6 mbrëmjes tri persona të veshur me uniformat e UÇK-së kanë
7 shkuar në shtëpinë Jelic dhe kanë marrë Jelic Marko në një
8 drejtim të paditur."

9 Pra ju po thoni që këtu kur thuhet "informatave që ka
10 dhënë familja", këtu bëhet fjalë për kumatën tuaj, kështu?

11 PË. Po.

12 PY. Thotë:

13 "Më vonë gjatë vitit në 1999-n, familja është takuar me
14 disa anëtarë të UÇK-së po nuk arriti të merrte asnjë
15 informacion sepse anëtarët e UÇK-së u befasuan kur dëgjuan për
16 këtë rast rrëmbimi. Takimi ishte organizuar nga OSBE-ja
17 meqenëse Jelic Marko punonte si përkthyes për OSBE-në."

18 Edhe këtë informacion e ka dhënë kunata juaj për Kryqin e
19 Kuq Ndërkombëtar?

20 PË. Nuk e di. Nuk e di çfarë u ka thënë. Nuk e di.

21 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që të
22 pranohet raporti prej dy faqesh i Kryqit të Kuq Ndërkombëtar,
23 KNKK-së.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
25 kundërshtime?

Dëshmitarja: Stamena Jelic (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Ellis

Faqe 71

1 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Jo.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Verifikojmë
3 një herë numrin, ju lutem. A bëhet fjalë për materialin me
4 numër SPOE001955525?

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Besoj se ky është numri. Më falni sa
6 ta gjej numrin.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Se nuk e kam
8 numrin këtu të shkruar.

9 Z. ELLIS: [Përkthim] Po, bëhet fjalë për materialin që
10 mban numrin 105526. Janë dy faqe.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
12 [Përkthim] Materiali me numër 105525 deri në 526
13 pranohet.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
15 materiali do të marrë numrin e provës 4D86, dhe ju lutem të më
16 thoni çfarë klasifikimi do të ketë.

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk e di a do të jetë një
18 konfidencial sepse është dokument i KNKK-së.

19 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] E ruajmë një herë klasifikimin
20 konfidencial dhe e verifikojmë më pas me burimin e
21 informacionit.

22 Z. ELLIS: [Përkthim]

23 PY. Pyetjet e fundit lidhen me Ismet Tarën. Sot paradite në
24 faqen 16, rreshti 21 i transkriptit provizor, ju thatë se
25 kishit dëgjuar nga personat e Rahovecit se Ismet Tara ishte

1 përgjegjës për zhdukjen e personave. A ju kujtohet kjo
2 përgjigje që i dhatë, besoj se ja keni dhënë Prokurorisë sot
3 paradite?

4 PË. Po.

5 PY. Dhe hera e parë që e keni thënë këtë ka qenë diçka që e
6 keni thënë gjatë seancës përgatitore me Prokurorisë në shtator
7 të këtij viti dhe kjo është hedhur në Shënimin Përgatitor 2,
8 që mban numrin 122937, paragrafi 7. Ju keni thënë se kur keni
9 shkuar te shoqata për personat e zhdukur dëgjuat nga një grua
10 atje që po ashtu i kishin rrëmbyer burrin, prej kësaj gruaje
11 ju dëgjuar që përgjegjës për zhdukjet ishte Ismet Tara dhe se
12 ju e njihnit atë.

13 A ja keni thënë këtë Prokurorisë gjatë seancë
14 përgatitore?

15 PË. Po, këtë kam thënë.

16 PY. Meqë këtu nuk është emri i zbardhur në shënimin
17 përgatitor, pajtoheni me mua që në fakt Prokurorisë nuk ja
18 keni thënë emrin e asaj gruas prej të cilës e morët këtë
19 informacion? Kështu?

20 PË. Ajo gruaja ka vdekur.

21 PY. Në rregull. Një çast, ju lutem.

22 [Përfaqësuesit e Mbrojtjes këshillohen]

23 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kaq pyetje
24 kisha për dëshmitaren.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka pyetje

Dëshmitarja: Stamen Jelic (Seancë private)
Pyetje nga Trupi Gjykues

Faqe 73

1 shtesë nga Prokuroria?

2 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Jo.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi

4 Gaynor, ju kishit pyetje?

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

6 Pyetje nga Trupi Gjykues:

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po ju lutem të kalojmë në

8 seancë private.

9 [Seancë private]

10 [Seancë private teksti i fshirë]

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitarja: Stamera Jelic (Seancë private)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 74

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12 [Seancë e hapur]

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nuk kam më pyetje për ju.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prokuroria ka
16 pyetje të mëtutjeshme në bazë të pyetjeve të Gjykatësve?

17 ZNJ. INSINGA: [Përkthim] Jo.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws?

19 Z. LAWS: [Përkthim] Jo, nuk kam pyetje.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbrojtja e
21 Thaçit?

22 ZNJ. TAVAKOLI: [Përkthim] Jo.

23 ZNJ. ROWAN: [Përkthim] Jo.

24 Z. ROBERTS: [Përkthim] Jo.

25 Z. ELLIS: [Përkthim] Kam nja dy pyetje që lidhen me

1 pyetjet e Gjykatësit Gaynor.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Patjetër.

3 Z. ELLIS: [Përkthim] Duhet të kalojmë në seancë private
4 që të flasim për dokumentin.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

6 Z. ELLIS: [Përkthim] Atëherë do të duhet të kalojmë
7 sërish në seancë private.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem të
9 kalojmë sërish në seancë private.

10 [Seancë private]

11 [Seancë private teksti i fshirë]

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19 [Seancë e hapur]

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

22 Dëshmitar, faleminderit që ishit këtu, që ndatë me ne

23 informatat tuaja. Nuk keni më detyrime ndaj kësaj Gjykate.

24 Mund të largoheni. Asistentja e Gjykatës do t'ju shoqërojë.

25 Faleminderit edhe një herë që erdhët.

1 DËSHMITARJA: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]

2 Faleminderit. Ju bekoftë Zoti.

3 [Dëshmitarja largohet përmes videolidhjes]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

5 Shihemi nesër në orën 9.00.

6 --- Seanca mbyllet në orën 12.26

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25